

Mbrojtja e të Drejtave të Pakicave Kombëtare në Shqipëri në Kuadër të Kushteve të Zgjerimit të BE-së

The Protection of Minority Rights in Albania through EU's Enlargement Conditionality

Publisher: EU Policy Hub / Forumi i Politikave të Integritimit
Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2, Tiranë, Shqipëri

Website: www.eupolicyhub.eu

E-mail: info@eupolicyhub.eu

Author: Bledar Feta

Spetember 2019

Ky botim u realizua me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë –Soros. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e Fondacionit Soros



Mbrojtja e të Drejtave të Pakicave Kombëtare në Shqipëri në Kuadër të Kushteve të Zgjerimit të BE-së

Bledar Feta

Specialist i Marrëdhënieve Ndërkombëtare

Bashkimi Evropian (BE) luan rolin më të rëndësishëm në promovimin e të drejtave të pakicave kombëtare përmes kushteve që përmban procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Përsa i përket mbrojtjes së minoriteteve, Shqipëria mund të konsiderohet një shtet kandidat ku ekzistojnë dy aspekte të kundërta. Nga njëra anë, autoritetet shqiptare kanë riformuar pjesën më të madhe të sitemit ligjor, të rregulloreve dhe të strukturave të brendshme duke përbushur disa nga standartet e parashikuara nga BE-ja. Nga ana tjetër, ky kuadër ligjor ambicioz, i cili konsiderohet thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, është ende largë implementimit dhe zbatimit të plotë. Implementimi i ligjeve dhe politikave të ndryshme në Shqipëri ka qënë gjithmonë problematik për shkakë të polarizimit të klasës politike dhe mungesës së vullnetit politikë. Ndikimi i politikave të BE-së varet nga klasa politike e brendshme e cila harton normat sipas interesave personale. Si rezultat, adoptimi i normave evropiane në formën e reformave ose ligjeve të reja ka ndihmuar që Shqipëria të përparojë me anëtarësimin e saj në BE, por nuk ka ndihmuar në përmirësimin e standarteve të jetesës ose të statusit të pakicave kombëtare. BE-ja duhet të adresojë problematikat e politikës shqiptare në mënyrë që efekti i politikave të zgjerimit të bëhet i dukshëm në jetën e përditshme të qytetarëve shqiptarë.

Sistemi i Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Pakicave: Pa Standarte të Përbashkëta

Të drejtat e personave që i përkasin pakicave janë një pjesë integrale e të drejtave themelore të njeriut, të cilat jo vetëm janë pjesë kryesore e vlerave të Bashkimit Evropian, por edhe përbëjnë një element thelbësor në procesin e zgjerimit të BE-së. Në fushën e mbrojtjes së pakicave, BE-ja ka adoptuar një qasje të dyfishtë ku mund të konstatohen dy dimensione, një i brendshëm (shtetet anëtare) dhe një i jashtëm (shtetet kadidate dhe potenciale kadidate). Në dimensionin e brendshëm, angazhimi i shteteve anëtare të BE-së për mbrojtjen e minoriteteve rrjedh nga Traktati i Lisbonës i cili integroi për herë të parë termin "personat që ju përkasin pakicave" në legjislacionin themelor të Bashkimit Evropian. Neni 2 i [Traktatit të Bashkimit Evropian \(TEU\)](#) i referohet të drejtave të minoriteteve në mënyrë të qartë duke deklaruar se "Unioni ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave". Për më tepër, neni 21 i [Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian](#) nënvizon se përkatësia në një pakicë kombëtare është një nga arsyet mbi të cilat ndalohet diskriminimi i një personi. Edhe pse të gjitha shtetet anëtare janë të detyruara tju garantojnë minoriteteve gëzimin e plot të të drejtave të tyre, në praktikë pakicat ende përballen me fenomene të ndryshme diskriminimi dhe shumë herë bëhen pjesë e stereotipeve poshtëruese dhe ofenduese. Gjithashtu, edhe të drejtat e tyre të fituara shpesh kufizohen ose zbatohen në mënyrë selektive.

- Sistemi i Bashkimit Evropian për mbrojtjen e pakicave nuk ju garanton pakicave gëzimin e plot të të drejtave të tyre.
- BE nuk ka mekanizma për të vlerësuar angazhimin e shteteve përsa i përket kritereve të Kopenhagës pasi ato bëhen shtete anëtare.
- BE-së i mungojnë mjetet e posaçme për të monitoruar dhe forcuar mbrojtjen e të drejtave të pakicave.
- BE nuk ka standarte të përbashkëta për mbrojtjen e minoriteteve as për njohjen e statusit të tyre si minoritet.
- BE-ja nuk ka krijuar një institucion në nivel evropian për njohjen dhe mbrojtjen e pakicave.
- Jo të gjitha shtetet anëtare të BE-së kane firmosur Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCNM) dhe Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare.
- BE-ja nuk ka miratuar standarte minimale të përbashkëta për mbrojtjen e minoriteteve.

Burimi: Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi Standartet Minimale për Minoritetet në BE.

së drejt mbrojtjes së pakicave ka sjell fryte të konsiderueshme, siç është përmirësimi i kornizave ligjore. Megjithatë, mospërputhja midis veprimeve të brendshme dhe të jashtme të BE-së ka rritur hezitimin e qeverive të shteteve kandidate dhe potenciale kandidate për të punuar më konkretisht drejt zbatimit të reformave në fusha të ndryshme, përfshirë këtu dhe mbrojtjen e minoriteteve. Dështimi i Brukselit për të arritur koherencën e normave në vetëvete ndikon negativisht në aftësinë e Bashkimit Evropian për të bindur të tjerët të zbatojnë rregullat e tij. Si rezultat, përpjekjes së Shqipërisë për të mbrojtur të drejtat e minoriteteve i mungonë një perspektivë e qartë integruese. I gjithë procesi është parë vetëm si një detyrim që vendi të avancojë me anëtarësimin në BE dhe jo si një domosdoshmëri e shoqërisë shqiptare për tju përgjigjur tendencave dhe sfidave të menaxhimit të diversitetit të shekullit njëzet e një. Bashkimi Evropian zakonisht aplikon taktikën e "shkopit dhe karotave" ku shkopi lidhet me çështjet e mbrojtjes së pakicave dhe karotat me perspektivën e Shqipërisë në BE. Çdo vendimi të miratuar nën këto taktika i mungon vullneti i vërtet politikë dhe mbështetja e mjaftueshme e shoqërisë, një realitet i cili pengonë progresin real në terren. Progresi

Situata problematike në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave konstatohet edhe nga [Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi Standartet Minimale për Minoritetet në BE](#), e cila u miratua në Nëntor të vitit 2018. Rezoluta zbulon mospërputhje në sistemin e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e pakicave. Mospërputhjet janë të shumta në disa nga shtetet anëtare sidomos kur bëhet fjalë për respektimin e të drejtave të pakicave dhe për njohjen e statusit të tyre si minoritet. Politika e BE-së për pakicat duket së gjendet akoma në një fazë fillestare, pasi Brukseli nuk është ende në gjendje të ofrojë një model të përbashkët standartesh për mbrojtjen e tyre në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Mungesa e standarteve të përbashkëta brënda BE-së ngjall dyshime për besueshmërinë dhe kontributin e Bashkimit Evropian në mbrojtjen e minoriteteve jashtë familjes evropiane, veçanërisht në shtetet e Ballkanit Perëndimor që aspirojnë të bëhen shtete anëtarë në të ardhmen. Brukseli është akuzuar për standarte të dyfishta, pasi kërkon nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të nënshkruajnë Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare si një kusht për të avancuar me tejë me anëtarësimin e tyre në BE, kur në të njëjtin moment vende anëtare të BE-së nuk kanë ende nënshkruar Kartën. Kjo qasje e dyfishtë ka vënë në pikëpyetje besueshmërinë e procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor.

Kjo nuk do të thotë se përpjekjet e ndërmarra nga BE-ja në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të pakicave në kuadër të procesit të zgjerimit përbëjnë një mision të dështuar; përkundrazi, roli pozitiv i BE-

real duhet të jetë në një masë të madhe i orientuar drejt përmirësimit të kushteve të pakicave në të gjitha aspektet e jetës së tyre.

Është e domosdoshme për BE-në dhe për besueshmërinë e politikave të Brukselit të mos përdor standarte të dyfishta kur bëhet fjalë për të drejtat e minoriteteve, qoftë brënda apo jashtë kufijve të tij. Bashkimi Evropian duhet të marrë më shumë masa për mbrojtjen e minoriteteve siç është miratimi i standarteve të përbashkëta të cilat do të përfshihen në një direktivë përkatëse.

Mbrojtja e të Drejtave të Pakicave Kombëtare në Ballkanin Perëndimor: Kusht për tu Anëtarësuar në BE

Strategjia e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor përmban kushtet e pranimit të shteteve aspiruese në familjen evropiane. Në këtë kontekst, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pjesë të së cilave janë edhe të drejtat e pakicave, janë formuluar si një kriter politik të cilin vendet aspiruese duhet të përmbushin për tu anëtarësuar në BE. Kushti për mbrojtjen e të drejtave të pakicave pasqyrohet në kriterin e parë të Kopenhagës i cili përmënd me qartësi "respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve". Sipas këtij kriteri politik, vendet e Ballkanit Perëndimor i nënshtrohen një sër kushteve përsa i përket politikës së tyre ndaj pakicave duke marrë përsipër detyrimin e harmonizimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së (acquis). Shtetet aspiruese për anëtarësim në Bashkimin Evropian janë të detyruara të miratojnë standarte specifike për mbrojtjen e pakicave të cilat janë të formuluar në politikën e zgjerimit të BE-së, në procesin e stabilizim-asociimit (SAP), si dhe në instrumentet që i shoqërojnë.

Qasja e Brukselit ndaj Pakicave në Ballkanin Perëndimor: Mungesë Koherence

Megjithëse mbrojtja e pakicave është një nga prioritetet e procesit të zgjerimit të BE-së që duhen adresuar nga shtetet aspiruese, qasja e Brukselit ndaj

trajtimit të pakicave dhe të drejtave të tyre vuan nga paqartësia, nga mungesa e koherencës dhe vazhdueshmërisë. Bashkimi Evropian nuk ka arritur të krijojë një mekanizëm të përbashkët me standarte specifike për mbrojtjen e pakicave të cilat të ndiqen nga secili shtet kandidat ose potencial kandidat. Përkundrazi, prioritetet e lidhura me pakicat janë formuluar në një mënyrë shumë të gjerë bazuar në standartet e parashikuara nga konventat rajonale edhe ndërkombëtare, si dhe në disa kritere të paqarta që në një farë mënyre pasqyrojnë këskesat e disa grupeve minoritare në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Kjo reflektohet qartazi në strategjitë e zgjerimit të Bashkimit Evropian ndër vite. Në raportet e para të Strategjisë së Zgjerimit, Komisioni Evropian (KE) nuk i referohet qartazi të drejtave të personave që i përkasin pakicave, por thjesht flet "për një frym tolerance ndaj pakicave" edhe për obligimin e shteteve aspiruese "të ndërmarrin masat e përshtatshme për mbrojtjen e individëve që mund të jenë subjekt diskriminimi, armiqësie ose dhune" ([Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2007-2008](#), f.6). Duket se treni i politikave për mbrojtjen e pakicave kombëtare u vë në lëvizje në emër të stabilitetit dhe sigurisë së rajonit. Komisioni Evropian nuk i dha rëndësinë e duhur dimensionit më kryesor të kësaj çështjeje, kontekstit shoqëror.

Në vitet në vijim, mbrojtja e të drejtave të pakicave u pa vetëm si një çështje sigurie, një dimension i cili mbizotëroi mbi dimensionin social. Në Strategjinë e Zgjerimit të vitit 2008, KE i trajton pakicat përsëri vetëm si një çështje sigurie duke nënvizuar se "dialogu midis forcave politike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe fryma e

kompromisit janë ende të pamjaftueshme, përfshirë këtu dhe çështjet që lidhen me etninë” ([Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2008-2009](#), f.3). U deshën shumë vjetë që KE-ja të merej me dimensionin shoqëror të çështjes së minoriteteve. Kjo erdhi si rezultat i krizës ekonomike që ndikoi negativisht mirëqenien sociale dhe marrëdhëniet shoqërore jo vetëm në shtetet aspiruese por edhe në vendet anëtare të BE-së. Duket se zhvillimet sociale dhe ekonomike e bën Brukselin të adoptojë qasje më të përqëndruar në çështjet sociale, sidomos në ato që lidhen me rritjen e nacionalizmit, populizmit dhe gjuhës së urrejtjes. Ishte atëherë, kur KE-ja njohu situatën problematike të pakicave në shtetet e Ballkanit Perëndimor duke deklaruar se “grupet vulnerable, përfshirë edhe pakicat, janë prekur veçanërisht nga kriza ekonomike” referuar politikave diskriminuese, si dhe kushteve të këqija të jetesës së minoritetit rom ([Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2010-2011](#), f.7). Por, edhe atëherë Brukseli nuk ishte në gjendje të ofronte masa dhe rekomandime konkrete për përballimin e situatës problematike në terren. Prandaj, Strategjia e Zgjerimit të vitit 2011 propozoi një qasje të re përsa i përket kapitujve të gjygjësorisht dhe të drejtave të njeriut duke prioritetizuar reformat në këto fusha, me qëllim trajtimin e sa më shpejt të rasteve të diskriminimit institucional dhe strukturor në baza etnike.

Në Strategjinë e Zgjerimit të vitit 2012, KE braktisi disi qasjen e paqartë dhe termat e karakterit të përgjithshëm dhe ju referua pakicave në një mënyrë më konkrete duke nënvizuar se “të drejtat e personave që u përkasin pakicave janë çështje kyç në të gjitha shtetet që aspirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian” ([Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2012-2013](#), f.5). KE shkon edhe më tej duke deklaruar se “qëndrimet ose sjellja e përgjithshme e shoqërisë ndaj grupeve vulnerable siç janë pakicat kombëtare mbeten një problem shqetësues në shtetet e Ballkanit Perëndimor”. Përfshirja e fjalës “shoqëri” shton atë dimensionin e duhur, i cili mungonte nga trajtimi i çështjes, një dimension i domosdoshëm në çdo proces që përpiqet të rregullojë marrëdhëniet e pakicave me shumicën. Duke patur parasysh se rregullimi i marrëdhënieve pakicë-shumicë, si dhe përfshirja e minoriteteve në jetën sociale, varen nga zbatimi i politikave, strategjia e rradhës e zgjerimit të BE-së trajton në veçanti boshllëkun që ekziston midis ligjeve në letër dhe zbatimit të tyre në praktik duke nënvizuar se “të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ndërmarrin masa të mëtejshme për të siguruar respektimin e të drejtave të pakicave në praktik dhe jo vetëm përcaktimin e tyre në ligj”

Dobësitë e qasjes së BE-së në Ballkanin Perëndimor

- Qasja e BE-së për mbrojtjen e të drejtave të pakicave në Ballkanin Perëndimor vuan nga paqartësia, mugesia e koherencës dhe vazhdueshmërisë.
- BE-ja nuk ka arritur të krijojë një mekanizëm të përbashkët me standarte specifike për mbrojtjen e pakicave kombëtare të cilat duhet të ndiqen nga secili shtet kandidat ose potencial kandidat.
- Prioritetet e lidhura me pakicat janë formuluar në një mënyrë shumë të gjerë bazuar në standartet e parashikuara nga konventat rajonale edhe ndërkombëtare, si dhe në disa kritere të paqarta që në një farë mënyre pasqyrojnë këskesat e disa grupeve minoritare në shtetet e Ballkanit Perëndimor.
- Nuk ekziston një mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e progresit të bërë nga çdo shtet aspirues.
- Nuk ka transparencë në zbatimin e angazhimeve të ndërmarrura nga qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- Mungesë e dukshmërisë së impaktit të reformave dhe komunikim i dobët i rezultateve të arritura.

([Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2013-2014](#), f.2). Pavarësisht deklaratave të forta të Brukselit, strategjia e BE-së vuante që në fillim nga një mungesë përgjegjësie dhe monitorimi mbi detyrimet e përcaktuara, e cila rezultoi në mos respektimin e disa standarteve për mbrojtjen e pakicave nga shtetet aspiruese dhe institucionet e tyre.

Në Strategjinë e Zgjerimit të vitit 2014, KE nënvizoi se gjendja e pakicave në rajon nuk kishte ndryshuar dramatikisht duke deklaruar se "ekziston nevoja për mbrojtje më të mirë të të drejtave të personave që ju përkasin pakicave dhe për trajtim më efektiv të diskriminimit" duke pranuar njëkohësisht se trajtimi i minoriteteve vazhdonte të ishte një problem serioz i rajonit. Për herë të parë, Këshilli i Evropës ngriti një numër çështjesh që duheshin trajtuar ngë vendet aspiruese si "përdorimi i gjuhëve të pakicave, e drejta për arsim, si dhe përfaqësimi politik dhe institucional i minoriteteve", ndërsa theksoi njëkohësisht domosdoshmërinë që "përfshirja e minoritetit rom të përkthehet në një prioritet kombëtar me vullnet të plot politik në të gjitha nivelet" ([Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-2015](#), f.14 dhe 15). Në këtë mënyrë, KE nënvizoi rëndësinë që institucionet evropiane i japin të drejtave të pakicave duke i konsideruar ato si një vlerë themelore në zemër të procesit të anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE.

Në vitet në vijim, politika e zgjerimit kaloi në plan të dytë, një zhvillim i cili pasqyroi agonit e brendshme ekonomike, politike dhe ideologjike të Unionit. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, nuk pati ndonjë progres në qasjen e BE-së përsa i përket mbrojtjes të së drejtave të pakicave kombëtare. Çështjet e brendshme që lidhen me qëndrueshmërinë e BE-së por edhe çështjet e jashtme më të ngutshme, si kriza e refugjatëve, devijuan vëmendjen e liderëve evropian nga pakicat kombëtare. Në Strategjinë e Zgjerimit të vitit 2015, KE i kushtoi vetëm katër fjali minoriteteve duke deklaruar se "ekziston nevoja për mbrojtje më të mirë të të drejtave të pakicave kombëtare, në veçanti atyre të minoritetit rom. Minoriteti rom vazhdonë të jetë viktim e racizmit, diskriminimit dhe përjashtimit shoqëror në vendet e Ballkanit Perëndimor ku shumica e romëve jeton në varfëri të thellë, pa akses të mjaftueshëm në shëndetësi, arsim, strehim dhe punësim" ([Strategjia e Zgjerimit të Bashkimit Evropian 2015](#), f.6 dhe 7). Në Komunikimin e Komisionit Evropian për Politikën e Zgjerimit të vitit 2016 nuk ka asnjë referencë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, një nevojë e përmendur gjerësisht në strategjitë e mëparshme. Komunikimi i referohet vetëm gjendjes së minoritetit rom duke nënvizuar se "situata në Ballkanin Perëndimor nuk ka ndryshuar. Romët vazhdojnë të jenë viktim të diskriminimit dhe të mos përfshirjes në jetën sociale" ([Komunikimi i Komisionit Evropian për Politikën e Zgjerimit të BE-së 2016](#), f.4).

Raporti i fundit i Strategjisë së Zgjerimit nuk shkon më tej përsa i përket pakicave. BE-ja thjesht ripërsërit vetveten duke nënvizuar se "nevojiten masa dhe përpjekje vendimtare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave si dhe për të luftuar diskriminim, sidomos kundër romëve, përfshirja e të cilëve në jetën sociale duhet promovuar më fuqishëm" ([Strategjia e Zgjerimit të BE-së 2018](#), f.4 dhe 5). Në të gjitha raportet e fundit të zgjerimit, KE duket se përsërit vetëveten në lidhje me prioritetet kyç për mbrojtje e të drejtave të pakicave. Kjo përsëritje mund të jetë një shenjë stagnimi, e cila tregon se qasja ekzistuese e BE-së nuk tejkalon retorikën e premtimeve deklarative të "promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave". Strategjisë ekzistuese i mungojnë mjetet dhe kriteret efektive për të monitoruar dhe vlerësuar përmbushjen e detyrimeve të përmara nga shtetet aspiruese, diçka e cila minon zbatimin efektiv të prioritetëve dhe angazhimeve në lidhje me respektimin e të drejtave të minoriteteve.

[Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve gjatë Procesit të Zgjerimit të BE-së](#), e nënshkruar në Korrik të vitit 2019 si pjesë e Procesit të

Berlini, mund të konsiderohet si një hap shtesë për të mbuluar boshllëqet ekzistuese, të paktën përsa i përket minoritetit rom. Përmes miratimit të kësaj deklarate, kryeministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor materializuan premtimet e tyre për përshejtimin e integritit të romëve. Deklarata parashikon arritjen e disa objektivave specifike në fusha të ndryshme si punësimi, strehimi, arsimit, shëndetësia, dokumentacioni dhe lufta kundër diskriminimit. Gjithëashtu, krijon pikat e referimit dhe principet bazë, të cilat janë të nevojshme për arritjen e objektivave të përcaktuara, përfshirë këtu koordinimin e brendshëm, miratimin e buxhetit në lidhje me integrimin e romëve, krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, si dhe përfshirjen e minoritetit rom në formulimin e politikave të posaçme. Ky hap i cili vendos romët në zemër të sistemit të mbrojtjes së pakicave të BE-së erdhi në momentin e duhur për tu përballuar me zhgënjimin e krijuar nga kushtet e vështira të jetesës së minoritetit rom në vendet e Ballkanit Perëndimor. Me këtë angazhim, BE-ja dhe vendet e Ballkanit Perëndimor arritën të mbajnë disi momentum-in e politikave të zgjerimit.

Megjithatë, këto janë vetëm dispozita të llojit deklarativ që i japin shteteve aspiruese një hapësirë të gjerë, duke lënë zbatimin e objektivave të deklaruara në vullnetin e politikëbërësve. Qëndrueshmëria e procesit dhe implementimi i objektivave varen nga ekzistenca e vullnetit politik dhe kushteve sociale që ndikojnë qëndrimet e politikëbërësve. Kjo kërkon një planifikim të mirë dhe hartimin e një strategjie e cila do bëjë të dukshëm impaktin e politikave integruese në shoqëri. Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Brukseli duhet të sjellin këtë iniciativë më afër tek qytetarët duke vendosur politikën e BE-së për pakicat në kontekstin politik dhe social-ekonomik të rajonit, si një përpjekje për të korigjuar kufizimet dhe mangësitë ekzistuese. Bashkimit Evropian i nevojitet një qasje e re dhe gjithëpërfshirëse për të mbështetur më mirë vendet e Ballkanit Perëndimor, gjithmonë në përputhje me kërkesat që krijojnë zhvillimet e reja në terren.

FCNM: Mjeti i BE-së për të Monitoruar Progresin në Fushën e Mbrojtjes të së Drejtave të Pakicave

Në mungesë të standarteve të veta për mbrojtjen e pakicave, BE-ja përdor standartet e hartuara nga Këshilli i Evropës (CoE) për të monitoruar progresin e bërë në lidhje me

mbrojtjen e të drejtave të pakicave si një nga prioritetet e procesit të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. CoE përfshihet në monitorimin e mbrojtjes të së drejtave të minoriteteve përmes një sistemi raportimi i krijuar në bazë të [Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare \(FCNM\)](#), e cila përmban një numër parimesh të rëndësishme. Neni 1 i Konventës nënvizon se "mbrojtja e pakicave kombëtare përbën pjesë integrale të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut". E drejta e vetë-identifikimit është e garnatuar në Nenin 3 të Konventës ku sqarohet se "çdo person që i përket një pakice kombëtare ka të drejtë të zgjedhë lirisht për tu trajtuar apo jo si i tillë". Dispozitat e këtij instrument të detyrueshëm ligjërishit përmbajnë standarte dhe parime specifike për mbrojtjen e pakicave që palët kontraktuese janë të detyruara ti zbatojnë në shkallë kombëtare përmes miratimit të masave të duhura legislative dhe administrative.

Këto parime/standarte përfshijnë:

- ndalimin e diskriminimit (neni 4). Palët kontraktuese janë të detyruara të promovojnë trajtimin e barabartë të personave që ju përkasin pakicave në të gjitha aspektet e jetës së tyre.
- mbrojtjen e identitetit kulturor, gjuhësor dhe fetar (neni 5) si dhe promovimin e tolerancës dhe dialogut ndërkulturor (neni 6). Palët kontraktuese duhet të krijojnë

kushtet e nevojshme për ruajtjen e identitetit të minoriteteve duke shmangur çdo veprim që mund të çojë në asimilim të detyruar (neni 16).

- lirinë e shprehjes, lirinë e grumbullimeve paqësore, lirinë e organizimit, dhe lirinë e mendimit, ndërjegjes dhe besimit fetar (nenet 7 dhe 8). Palët kontraktuese duhet të sigurojnë që pakicat të gëzojnë të drejtën për të manifestuar fenë dhe besimin e tyre si dhe për të krijuar organizata dhe shoqata fetare.
- aksesin në media (neni 9). Përmes kësaj dispozite, palët kontraktuese duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar aksesin e personave që ju përkasin pakicave në media dhe në të njëjtën kohë nuk duhet të pengojnë krijim dhe përdorimin e medias nga pakicat.
- përdorimin e gjuhëve të pakicave (nenet 10 dhe 11). Palët kontraktuese duhet tu njohin minoriteteve të drejtën e përdorimit të gjuhëve të tyre në jetën private dhe publike, në arsim, media dhe kontaktet zyrtare si dhe të drejtën e përdorimit të emrave dhe të trguesve topografikë.
- të drejtat arsimore (nenet 12, 13 dhe 14). Palët kontraktuese duhet të sigurojnë që sistemi kombëtar i arsimit tju lejojë minoriteteve të mesojnë në gjuhën e tyre, si dhe të udhëzohen në gjuhën e tyre në të gjitha nivelet arsimore.
- të drejtën për pjesëmarrje dhe përfaqësim efektiv (neni 15). Sipas kësaj dispozite, palët kontraktuese duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e minoriteteve në të gjitha aspektet e jetës publike, si dhe në administratën qendrore dhe lokale.
- bashkëpunimin ndërkuftar (neni 17 dhe 18). Palët kontraktuese nuk duhet të pengojnë bashkëpunimin e pakicave me individë që jetojnë në shtete tjetra dhe me të cilët ndajnë një identitet të përbashkët etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar. Përkundrazi, ky lloj bashkëpunimi duhet të inkurajohet.

Meqënëse zbatueshmëria e dispozitave të mësipërme varet nga vullneti i shteteve anëtare të Konventës, formimi i një Komiteti Këshillëdhënës për të monitoruar implementimin e parimeve të Konventës u konsiderua i nevojshëm. Misioni kryesor i Komitetit Këshillëdhënës është shqyrtimi i raporteve të paraqitura nga shtetet anëtare dhe vlerësimi i përshtatshmërisë së masave të përmara në mënyrë që të konstatohet shkalla e harmonizimit të standarteve kombëtare me ato të Konventës dhe të përgatitet opinioni final i Këshillit mbi angazhimet e marra nga shtetet në fjalë. Komisioni Evropian përdor këtë mekanizëm për të pasqyruar prioritetet mbi mbrojtjen e pakicave në raportet e progresit si kërkesa që duhen realizuar nga vendet aspiruese. Ratifikimi i FCNM-s dhe pajtueshmëria me dispozitat dhe standartet e saj janë kërkesa thelbësore për vendet (potenciale) kandidate në mënyrë që të avancojnë me anëtarësimin e tyre në BE.

Investigimi i raport progresive të fundit tregon se shumica e shteteve të Ballkanit Perëndimor kanë krijuar kornizat ligjore për mbrojtje adekuate të pakicave, por nuk kanë mbushur detyrimet e tyre në lidhje me këtë mbrojtje në praktikë. Prandaj, nuk mund të flasim akoma për ekzistencën e një sistemi mbrojtës të institucionalizuar për pakicat në rajon ose për standarte të zbatuara në mënyrë efektive. Stagnimi i përparimit në fazën e implementimit mund të atribuohet një numri faktorësh si trashëgimive të ndryshme post-konfliktuale të rajonit, sensibiliteteve të shumta politike rreth çështjes së pakicave, mungesës së gatishmërisë politike për të marrë seriozisht çështjen e të drejtave të minoriteteve, dobësive të organeve që meren me të drejtat e njeriut dhe të mekanizmave të monitorimit në nivel kombëtar, mungesës së strukturave dhe hapësirave për të përfaqësuar pakicat në institucionet kombëtare, aftësive të dobëta të organizatave dhe të organeve që përfaqësojnë pakicat, si dhe konkurrencës së tepërt dhe jo të nevojshme që ekziston midis anëtarëve të bashkësive të ndryshme të pakicave. Njohja e pakicave kombëtare dhe të dhënat mbi numrin real të popullsisë së tyre ende mbeten një problem i madh për shkak të politizimit të procesit të regjistrimit të popullsisë. Shumica e tensioneve janë krijuar në lidhje me të drejtën e përdorimit të gjuhëve të pakicave, e cila konsiderohet si çështja më sensitive gjatë debateve për mbrojtjen e minoriteteve, ndërsa njohja e të drejtave arsimore vazhdon të jetë aspekti më

problematik, pasi këto të drejta janë ato të cilat shtetet janë më pak bujare për të promovuar.

Detyrimet dhe Përparimi i Shqipërisë Drejt Mbrojtjes së Pakicave Kombëtare

Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar dy dokumentat kryesore evropiane në lidhje me të drejtat e minoriteteve: [Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut \(ECHR\)](#) dhe [Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare \(FCNM\)](#). Angazhimet e Shqipërisë të parashikuara nga FCNM-ja u formuluan si prioritet afatshkurta në partenritetet Evropiane [2006](#) dhe [2008](#) që Këshilli Evropian adoptoi me Shqipërinë. Katalogu i prioritetëve të përcaktuara në të dyja dokumentat përmban: a) miratimin e një legjislacioni gjithëpërfshirës për pakicat kombëtare, b) grumbullimin e të dhënave statistikore të besueshme mbi popullsinë e minoriteteve, c) përdorimin e gjuhëve të pakicave, d) edukimin në gjuhën e pakicave, e) aksesin e pakicave në media dhe f) zbatimin e strategjisë kombëtare për minoritetin rom. Të gjitha këto çështje thelbësore janë pjesë e vlerësimit të Komisionit Evropian të reflektuara në të gjitha progres raportet si kushte që Shqipëria duhet të përmbush për të avancuar me anëtarësimin e saj në BE. Siç dëshmohet nga vlerësimi dhe krahasimi i raporteve të progresit të Komisionit Evropian të shtatë viteve të fundit, Shqipëria mund të konsiderohet si një student i bindur, as më i miri në klasën e Ballkanit Perëndimor por as edhe më i dobt.

Nivelet e Mbrojtjes të së Drejtave të Pakicave Kombëtare në Shqipëri



Zbatimi i Ligjit për Pakicat Kombëtare: Prioritet Kyç për Hapjen e Negociatave

Miratimi i një legjislacioni gjithëpërfshirës për minoritetet, i konsideruar si një kërkesë thelbësore për forcimin e sistemit mbrojtës së pakicave kombëtare në Shqipëri, ka qënë gjithmonë një nga prioritetet kryesore të identifikuar nga Komisioni Evropian ([Raporti i Progresit për Shqipërinë 2012](#), f.21). Çështja e mungesës së një kornize ligjore posaçërisht për pakicat është reflektuar edhe në opinion e parë ([2003](#)), të dytë ([2008](#)) edhe të tretë ([2012](#)) të Komitetit Këshillëdhënës të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Autoritetet Shqiptare pranuan se çështja e pakicave kishte nevojë për një fokus të veçantë ku të përfshinte miratimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e tyre në prioritetet e [Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013](#). Megjithatë, për një kohë të gjatë, çështja e miratimit të ligjit për pakicat kombëtare kaloi në plan të dytë të politikës shqiptare dhe raportet e progresit thjesht

përsërisnin mungesën e përparimit në adresim të këtij prioriteti kryesorë ([Raporti i Progresit për Shqipërinë 2016](#), f.68). Pamvarësisht presionit të vazhdueshëm ndërkombëtar, autoriteteve shqiptare iu desh më shumë se 10 vjet për të miratuar ligjin në fjalë, vonesë e cila tregon ngurrimin e qeverive shqiptare për të marrë riskun politik të adresimit të një çështjeje me interes kombëtar.

Autoritetet shqiptare e vunë trenin në lëvizje në vitin 2017, por ai nuk ka arritur ende në destinacionin e tij përfundimtar. Shqipëria duhet të miratojë legjislacionin sekondar, të krijojë mekanizmat e nevojshëm dhe të rishikojë legjislacionin ekzistues përkatës, si hapa të nevojshme për të siguruar zbatimin e të gjitha parimeve dhe të drejtave të përcaktuara në ligjin për mbrojtjen e pakicave kombëtare ([Raporti i Progresit për Shqipërinë 2019](#), f.30). Vonesa në miratimin e legjislacionit sekondar tregon se sa ngadalë po shkon treni shqiptar drejt krijimit të një sistemi gjithëpërfshirës për mbrojtjen e minoriteteve. Në mungesë të këtyre akteve ligjore, të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e ligjit, përpsektivat për çeljen e negociatave në Tetor të vitit 2019 janë të pakta. Respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare është një nga pesë kriteret kryesore që BE-ja i ka vendosur Shqipërisë për të hapur negociatat e anëtarësimit. Prandaj, autoritetet e vendit duhet të përparojnë sa më shpejt në këtë drejtim, nëse nuk dëshirojnë të devijojnë nga synimi për hapjen e negociatave në Tetor.

Të Dhëna të Besueshme Statistikore:

Të Domosdoshme për Hartimin e Politikave Minoritare

Mungesa e të dhënave të besueshme të popullsisë reale të pakicave në Shqipëri dhe diferencat e gjëra të statistikave në lidhje me numrin e individëve që ju

përkasin pakicave të ndryshme janë ndër fushat më të kritikuar në të gjitha progres raportet e Komisionit Evropian, por edhe në opinionet e Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s. Regjistrimi i Popullsisë është kthyer në një konkurs për legjitimitet dhe fuqi, ku çështja e përkatësisë etnike në formën e regjistrimit përfaqëson një shifër që tregon se sa fuqi zotëron shumica dhe përkatësisht sa fuqi ose të drejta mund të kërkojnë ose të pretendojnë pakicat. Si rezultat, procesi i regjistrimit të popullsisë është tepër politizuar. Mosmarrëveshjet mbi mënyrën se si duhet organizuar regjistrimi i pakicave kombëtare kanë çuar në bojkotimin e gjithë procesit nga pakicat ose në mos përfshirjen e etnisë në format e regjistrimit nga autoritetet shtetërore. Në [Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave të vitit 2001](#), i pari pas rënies së komunizmit, autoritetet shqiptare nuk përfshinë deklarin e kombësisë nga frika e implikimeve politike që mund të sillte përfshirja e përkatësisë etnike në pyetësor.

Në [regjistrimi e dytë të popullsisë dhe banesave, i mbajtur në vitin 2011](#), u përfshi pyetje opsionale mbi origjinën etnike, por besueshmëria e të dhënave të dala nga ky regjistrim u vu në dyshim për shkak të vendimit të qeverisë të aplikonte gjobë për pyetjet e pasakta mbi origjinën etnike të cilat vinin në kundërshtim me të dhënat e regjistruara në regjistrin civil. Kjo taktik çoi në bojkotimin e regjistrimit të popullsisë, si dhe në kontestimin e rezultateve të tij nga përfaqësuesit e pakicave. Në këto zhvillime, regjistrimi i popullsisë dhe banesave të vitit 1989 mbetet i vetmi regjistrim me informacion të besueshëm mbi numrin real të popullsisë së pakicave kombëtare në Shqipëri. Komisioni Evropian vazhdon të kërkojë shifra të azhurnuara dhe të besueshme në lidhje me numrin e minoriteteve për tu njohur më mirë profilin e vendit dhe për të planifikuar në mënyrë të arsyeshme ndarjen e fondeve të zhvillimit të BE-së. Prandaj, procesi i regjistrimit të popullsisë është i rëndësishëm jo vetëm sepse shërben si një imazh i vendit për jashtë por edhe sepse përcakton se ku do të shkojnë fondet e zhvillimit. Rëndësia e kësaj çështjeje reflektohet edhe në debatin publik intensiv mbi

metodologjinë dhe kohën e mbajtjes së regjistrimit i cili nuk kufizohet vetëm brenda institucioneve përkatëse statistikore, por shtrihet edhe në skenën e gjerë politike.

Ekzistenca e të dhënave të besueshme mbi popullsinë e pakicave është me të vërtet një temë shumë e rëndësishme sepse gëzimi i disa të drejtave të pakicave lidhet drejtëpërdrejtë me numrin e tyre në secilën njësi të qeverisjes vendore. Për shembull, pakicat kombëtare mund të përdorin gjuhën e tyre në komunikim me autoritetet publike vetëm në njësitë e qeverisjes vendore ku numri i tyre përbën 20 përqind të popullsisë së përgjithshme të njësisë ([Liqji 96/2017 për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare](#), Neni 15). Prandja, informacioni ose numrat që nuk pasqyrojnë realitetin në terren mund të përjashtojnë disa grupe minoritare nga gëzimi i të drejtave të tyre. Ekuacioni bëhet më kompleks nëse marrim parasysh ndarjen e re administrative dhe territoriale të Shqipërisë, e cila krijoi bashki të përziera dhe më të mëdhaja ku pragu i 20 përqindë për pakicat në lidhje me popullsinë e përgjithshme të njërive lokale është shumë i vështirë, nëse jo i pamundur, të përmbushet. Ekziston një nevojë urgjente që autoritetet shqiptare jo vetëm të mbledhin këto të dhëna, por edhe të bazojnë grumbullimin e tyre në parimin e vetë-identifikim të lirë të personave me një pakicë kombëtare. Kjo do të jetë sfida më e madhe në regjistrimin e ardhshëm të popullsisë i cili është planifikuar të mbahet në vitin 2020. Regjistrimi i popullsisë në 2020-ën i jep Shqipërisë një mundësi për të sqaruar situatën statistikore të pakicave të saj kombëtare. Për të patur sukses në këtë mision, autoritetet shqiptare duhet të miratojnë sa më shpejt ligjin e ri për regjistrimin e popullsisë dhe të shfuqizojnë dispozitat që aplikojnë gjoba për përgjigje të pasakta mbi përkatësinë etnike duke shmangur në të njëjtin moment çdo veprim që mund të ushtrojë presion mbi zgjedhjen e lirë të çdo personi. Ndarja e aspekteve teknike dhe burokratike të procesit nga çështjet e gjëra politike, si dhe përpunimi i të dhënave në përputhje me standartet e BE-së janë vërtet të nevojshme. Procesi i regjistrimit të popullsisë duhet parë vetëm si një veprim burokratik i domosdoshëm për qëllime planifikimi dhe zhvillimi sepse mungesa e informacionit statistikor mund të pengojë seriozisht hartimin dhe monitorimin e politikave dhe praktikave që lidhen me të drejtat e pakicave kombëtare.

*Të Drejtat e Minoritetit Grek:
Një Numër Problemesh që Komplikojnë
Anëtarësimin e Shqipërisë në BE*

Numri i saktë i minoritetit grek dhe konstatimi demografik i zonave minoritare kanë qenë gjithmonë dy tema të nxehta midis qeverisë shqiptare dhe përfaqësuesve të pakicës greke. Përfaqësuesit e minoritetit grek pretendojnë se Shqipëria shkel të drejtat e tyre duke mirtuar

masa të cilat synojnë në uljen artificiale të numrit të vërtet të popullsisë së tyre, kurse autoritetet shqiptare pretendojnë se të drejtat e pakicës greke respektohen në përputhje me të gjitha normat ndërkombëtare. Në faktë, minoriteti grek është kthyer në një barometër i marrëdhënieve Shqiptaro-Greke duke komplikuar më tej procesin e anëtarësimin të Shqipërisë në BE.

Mbrojtja e të drejtave të minoritetit grek është objektiv kryesor i politikës së jashtme greke. Qeveria e sapokrijuar e Demokracisë së Re (ND) ka lidhur në mënyrë direkte çështjen e të drejtave të minoritetit grek me mbështetjen e Greqisë për perspektivën evropiane të Shqipërisë. Athina ka deklaruar se aspiratat e Shqipërisë për tu bërë pjesë e BE-së mund të rrezikohen nëse Tirana nuk arrinë të mbrojë të drejtat e pakicave, diçka e cila ka inkurajuar spekulimet se qeveria e re mund të bllokojë çeljen e negociatave me Shqipërinë në Tetor. Kryeministri i ri i Greqisë, Kiriakos Mitsotakis e ka bërë të qartë se hapja e negociatave do të varet nga respektimi i të drejtave pronësore të pakicës greke, si dhe nga gatishmëria e qeverisë shqiptare për të shfuqizuar në praktikë të

ashtuquajturat zonat e minoritetit. Duket se qeveria e re do të presë veprime konkrete nga Tirana drejt këtij drejtimi për të dhënë dritën jeshile në Tetor.

Nëse Athina nuk bindet, do të refuzojë hapjen e negociatave me Shqipërinë duke ndjekur shembullin e shteteve tjetra anëtare, si Holanda dhe Franca, të cilat kanë deklaruar të bëjnë të njëjtën gjë bazuar në progresin e bërë ose jo në fushat e pesë prioritetëve kyçe. Në qoftë se Shqipëria arrin të marrë dritën jeshile në Tetor, të drejtat e minoritetit grek nuk do të ndalojnë të jenë barrë për Tiranën pasi Athina mund të gjejë më të dobishme promovimin e të drejtave të tyre gjatë negociatave të Kapitullit 23 (Gjygjësori dhe të Drejtat Themelore). Proçesi i negociatave të kapitujve mund të krijojë hapësira për korrigjime ose përmirësime në pjesë të legjislacionit ose praktikave që sipas Greqisë shkojnë kundër interesave të pakicës greke. Me qasjen e re të BE-së për hapjen e kapitujve 23 dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria) në fillim të negociatave për anëtarësim, ritmi i proçesit të pranimit të Shqipërisë do të varet kryesisht nga implementimi i planit të veprimit në lidhje me këto dy kapituj, si dhe nga rritja e aftësisë administrative për të zbatuar *acquis-in*. Mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat e pakicës greke midis Tiranës dhe Athinës mund të zgjasin proçesin e pranimit të Shqipërisë në BE.

*Përdorimi i Gjuhëve të Pakicave:
Çështja më Sensitive Gjatë Debateve
për Mbrojtjen e Minoriteteve*

Shqipëria hynë në kategorinë e shteteve me progres të ngadaltë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, e mbetur shumë pas në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor pasi është i vetmi shtet i rajonit, anëtar i Këshillit të Evropës, që nuk ka nënshkruar [Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare](#). Mosgatishmëria e Shqipërisë për të nënshkruar dokumentin kryesor evropian që mbron dhe promovon gjuhët rajonale dhe ato minoritare ka të bëjë me situatën shumë problematike që ekziston në terren në lidhje me përdorimin e gjuhëve të pakicave. Të gjitha opinionet e Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s por edhe raportet e progresit të Këshillit Evropian identifikojnë një numër mangësish në lidhje me të drejtën e pakicave kombëtare në Shqipëri për të komunikuar me autoritet qeveritare edhe lokale në gjuhët e tyre, si dhe në lidhje me shfaqjen e emrave të vendeve, të rrugëve dhe të treguesve tjetër topografikë në gjuhët e pakicave kombëtare. Për një kohë të gjatë, nuk ekzistonte ndonjë dispozitë zyrtare për të administruar ose rregulluar përdorimin e gjuhëve të pakicave. Autoritetet shqiptare u përpoqën ta përballonin problemin me një numër marrëveshjesh të nënshkruara midis qeverisë qendrore dhe asaj lokale, duke u dhënë mundësinë disa grupeve minoritare të përdornin gjuhën e tyre në disa rrethana specifike. Megjithatë, këto marrëveshje dhe forca e tyre ligjore ishin të paqarta, duke e lënë adresimin e çështjes në fjalë në vullnetin e plot të autoriteteve lokale ([Opinion i Tretë i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s](#), f.23). Si rezultat, e drejta e minoriteteve për të përdorur ose marrë informacion në gjuhët e tyre nuk është e disponueshme për të gjitha pakicat e njohura zyrtarisht ([Raporti i Progresit për Shqipërinë 2013](#), f.45).

Ligji për mbrojtjen e pakicave mundohet të mbulojë disa nga këto boshllëqe, por përsëri situata mbi përdorimin e gjuhëve të minoriteteve mbetet akoma e paqartë. Nga njëra anë, ligji njeht të drejtën e pakicave për të përdorur gjuhët e tyre. Nga ana tjetër, e kufizon këtë të drejtë në njësitë vendore ku numri i pakicave përbën 20 përqind të popullsisë së përgjithshme të njësisë. Gjithashtu, ligji lidh ushtrimin e të drejtave gjuhësore me legjislacionin përkatës ekzistues ose me vendimet përkatëse administrative, duke e lënë zbatimin e tij në vullnetin e mirë të autoriteteve lokale. Si rezultat, të drejtat gjuhësore njihen vetëm në 3 bashki ku përmbushet pragu 20% –

bashkitë e Dropullit dhe Finiqit të banuara nga pakica greke si dhe bashkia e Pustecit, e banuar nga pakica maqedonase ([Opinion i Katërt i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s](#), f.24). Në këtë kontekst, minoritetet që jetojnë në një numër të konsiderueshëm jashtë territoreve tradicionale, psh. qytetet qëndrore, nuk gëzojnë të drejtën e përdormit të gjuhës së tyre.

Në kushtet ekzistuese, qeveria shqiptare nuk është në gjendje të sigurojë gëzimin efektiv të të drejtave gjuhësore jashtë zonave të banuara tradicionalisht nga pakicat. Qasja e përgjithshme e politikës shqiptare mbi përdorimin e gjuhëve të pakicave nënkupton një lloj kufizimesh si rrjedhojë e frikës se një hap i mëtejshëm drejt mbrojtjes së gjuhëve të pakicave kombëtare mund të rrezikonte kohezionin e vendit. Në formulimin e politikave gjuhësore ekzistonë gjithmonë një polemikë dhe mungesë konsensusi të cilat bashkë me mungesën e vullnetit politik kanë nxitur mosbesimin e pakicave në Shqipëri. I takon qeverisë shqiptare të krijojë marrëdhënie të besueshme me pakicat përmes aderimit të Shqipërisë në Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare si mjeti i vetëm efektiv për ruajtjen e të gjitha gjuhëve minoritare dhe për mbrojtjen e ekzistencës së tyre në plan afatgjatë. Respektimi i të drejtave gjuhësore të pakicave është thelbësor për avancimin e të drejtave të pakicave por edhe të të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Një sërë Kufizimesh në Lidhje me Njohjen e të Drejtave Arsimore

Legjislacioni shqiptar njeh të drejtën e pakicave kombëtare për të mësuar gjuhën e tyre përmes funksionimit të shkollave dhe klasave ku mësohet gjuha amtare, historia dhe kultura e vendit të origjinës. Megjithatë, autoritetet shqiptare ende nuk janë në gjendje të ofrojnë mësimdhënie në gjuhët minoritare për të nëntë pakicat e njohura zyrtarisht, sidomos për ato numerikisht më të vogla ([Opinion i Katërt i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s](#), f.30). Arsyet janë të shumta dhe të ndryshme, nga ato politike, siç është mungesa e vullnetit politik në nivel qëndror dhe lokal, te ato me natyrë më teknike, si mungesa e stafit mësimor, të ambienteve shkollore si dhe të librave shkollor në gjuhët e pakicave. Edukimi në gjuhët e pakicave është një çështje komplekse. Përmban një proces politik i cili kërkon vullnet politik dhe qasje përparimtare nga qeveritë përkatëse, si dhe një proces teknik i cili kërkon krijimin e disa mekanizmave për të siguruar përputhjen me legjislacionin përkatës. Sidoqoftë, gota mbetet gjysmë e mbushur, dhe jo gjysmë e zbrazur kur bëhet fjalë për kapacitetet e Shqipërisë për të ofruar arsim në gjuhët e pakicave.

Para miratimit të ligjit të ri për mbrojtjen e minoriteteve, funksionimi i shkollave dhe klasave me mësimdhënie në gjuhët e pakicave lejohej vetëm në ish "zonat minoritare". Me ligjin e ri, kjo praktikë braktiset dhe krijimi i shkollave me mësimdhënie në gjuhët e pakicave lejohet në "njësitë e vetëqeverisjes lokale ku pakicat jetojnë tradicionalisht ose në një numër të konsiderueshëm". Sidoqoftë, mbetet akoma të shihet se si do të funksionojë kjo dispozitë në praktikë. Zbatimi i kësaj dispozite varet nga [Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 561](#), i cili kushtëzon hapjen e shkollave ose klasave me mësimdhënie në gjuhët e pakicave në një numër kriteresh, përfshirë pragun e jo më pak se 15 nxënësve për klasë. Rreziku që kjo dispozitë të bëhet jo-funksionale në zonat me numër të vogël pakicash është i lartë, duke ngushtuar funksionimin e klasave me mësimdhënie në gjuhët e pakicave në zonat ku minoritetet janë më të përqëndruara, një zhvillim i cili do mbajë në funksion "zonat minoritare të epokës komuniste". Aktualisht, shkolla publike me mësimdhënie në gjuhën greke dhe maqedonase ekzistojnë në rrethet e Gjirokastrës, Sarandës, Delvinës dhe Korçës. Pakicat Greke dhe Maqedonase, në krahasim me pakicat e tjera të njohura zyrtarisht, mund të konsiderohen si më të

privilegjuarat. Megjithatë, të dyja grupet minoritare nuk janë të kënaqura me situatën aktuale dhe kërkojnë vazhdimisht hapjen e shkollave të reja, jashtë zonave minoritare. Kërkesat e tyre së bashku me kërkesat e pakicave serbe dhe arumune janë refuzuar nga qeveria shqiptare mbi bazën e mosrespektimit të kritereve të kërkuara. Si rezultat, përveç mësimdhënies në gjuhët greke dhe maqedonase, dhe në një masë të kufizuar në gjuhën rome, aktualisht nuk ekzistojnë shkolla me mësimdhënie në gjuhët e pakicave të tjera në Shqipëri ([Opinion i Katërt i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s](#), f.30).

Kërkesat e minoriteteve për arsim në gjuhët e tyre janë ato që shtetet janë më pak bujare për të promovuar. Ndërsa qeveria shqiptare nuk është kundër arsimit në gjuhët e pakicave, ekziston një tendencë për ti dhënë kësaj çështjeje një karakter nationalist ose patriotik si një mënyrë për të korrur përfitime në konkurrencën e brendshme politike. Kjo qasje shifet zakonisht në kërkesat e pakicës Greke. Tirana përpiqet të merret me këtë çështje në një mënyrë shumë të matur. Nga një anë, duke njohur rëndësinë e mos zemërimit të elektoratit shqiptar, mundohet të mos duket shumë e butë ose bujare ndaj kërkesave të minoritetit grekë (ka një përshtypje midis shqiptarëve që Tirana nuk duhet të pranojë kërkesat e pakicës greke nëse Athina nuk respekton të drejtat e emigrantëve shqiptar që jetojnë në Greqi, si përshebull të drejtën e tyre për të mësuar gjuhën amtare), kurse nga ana tjetër, mundohet të mos mërzhiten aleatët perëndimor të Shqipërisë që po i ushtrojnë presion për të bërë progres drejt mbrojtjes së pakicave kombëtare. Përpjekjet e Shqipërisë për të ruajtur këtë ekuilibër të vështirë mund të identifikohen në ligjin e ri për mbrojtjen e pakicave ku autoritetet kanë pranuar një numër të madhë të drejtash por kanë vendosur zbatimin e tyre nën disa kushte, duke kënaqur në këtë mënyrë audiencën ndërkombëtare por edhe atë vendase. Kjo taktikë e llogaritjeve politike ka devijuar në një farë mënyre vullnetin politik. Klasa politike shqiptare konsideron se ndryshimet rrënjësore dhe reformat progresive në fushën e arsimit të pakicave do të kenë një kosto të lartë politike.

Shqipëria po bashkëpunon në nivel dypalësh për të përballuar problemet e shfaqura në fushën e arsimit, siç është furnizimi i jo mjaftueshëm i librave shkollor në gjuhët e pakicave. Një shembull i kësaj qasjeje konstruktive është marrëveshja e përbashkët Tiranë-Athinë që lejon fëmijët e pakicës greke të kenë akses falas në librat shkollorë. Shqipëria dhe Greqia, gjithashtu, janë ri-angazhuar në dialog për çështje të tjera kyçe që lidhen me arsimin siç është rikrijimi i grupit të ekspertëve për rishikimin e teksteve shkollorë. Në axhendën e punës së grupeve të ekspertëve është ekzaminimi i mënyrës se si historia, letërsia, gjeografia, kultura dhe ekonomia paraqiten në tekstet shkollorë, në përpjekje për ti mbajtur ato në përputhje me frymën e UNESCO-s dhe Këshillit të Evropës. Një marrëveshje në këtë çështje mund të rezultojë në rishikimin e duhur të teksteve shkollorë i cili do të jetë fitimprurës si për Shqipërinë ashtu dhe për Greqinë, si dhe për pakicën Greke në Shqipëri. Megjithatë, ekzistenca e një ligji për pakicat dhe bashkëpunimet dypalëshe vetëm nuk mjaftojnë për zgjidhjen e të gjitha problemeve ekzistuese në fushën e arsimit të pakicave. Situata e arsimit në gjuhët e pakicave është ende mjaft shqetësuese. Vetëm një qasje e vendosur dhe e qëndrueshme, me një manifestim të madhë të vullnetit politik, do të rinovonte momentumin, ndërsa qartësia strategjike do të krijonte kushtet e zhvillimit të marrëdhënieve të besueshme midis pakicave dhe qeverisë, një parametër i domosdoshëm për zbatimin e reformave radikale që do të sigurojnë dhe rritin aksesin në arsim.

*Akresi i Pakicave në Media:
Një Manifestim i Pjekurisë Demokratike*

Akresi i minoriteteve në media është një aspekt thelbësor për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kulturor, si dhe për zhvillimin e tyre politikë dhe shoqëror. Në këtë kontekst, legjislati shqiptar

garanton të drejtën e lirisë së shprehjes dhe parashikon përdorimin e gjuhëve të pakicave në mediat elektronike edhe të shkruara. Shqipëria ka bërë përpjekje të konsiderueshme për të rritur aksesin e pakicave kombëtare në programe radiotelevizive në gjuhën e tyre. Në Shtator të vitit 2017, radiotelevizioni publik filloi të transmetojë programe në pesë gjuhë minoritare në RTSH2, një kanal televiziv i dedikuar pakicave kombëtare ([Raporti i Progresit për Shqipërinë 2018](#), f.31). Pa dyshim, ky është një hap pozitiv, por mangësitë në lidhje me kohëzgjatjen dhe përmbajtjen e programeve të transmetuara të cialt nuk u pergjigjen interesave, nevojave dhe problemeve reale të pakicave vazhdojnë të ekzistojnë akoma.

Media shqiptare nuk ka treguar interes për promovimin e minoriteteve dhe vlerave që përfaqësojnë si një urë bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe shteteve të tyre amë ([Opinion i Dyte i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s](#), f.21). Përkundrazi, polarizimi i mediave dhe standartet e dobëta profesionale të gazetarëve kanë kontribuar në politizimin e çështjeve minoritare dhe në rritjen e paragjytimeve kundër tyre duke penguar aksesin në informacion të saktë dhe në këndvështrime të ndryshme. Kjo situatë shqetësuese kërkon që Shqipëria të ndër marrë masa për të krijuar një kulturë mediatike kongruente me standartet evropiane. Klasa politike shqiptare nuk duhet të nënvlerësojë efektet negative që kakofonia e medias mund të krijojë në marrëdhëniet pakicë-shumicë, si dhe në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe shteteve amë të pakicave. Numri i kufizuar i shtypit minoritar, i cili varet kryesisht nga fondet e jashtme dhe nga grantet ndërkombëtare, nuk ndihmon në trajtimin e kakofonisë së mediave. Rritja e zërave të pakicave përmes krijimit të mediave të tyre do të përbëjë një element të rëndësishëm drejt përparimit. Krijimi i kushteve të nevojshme që do ti lejojë pakicave kombëtare të krijojnë mediat e tyre dhe të përdorin shërbimet mediatike pa diskriminim do të jetë testi i ardhshëm për klasën politike shqiptare i cili do të tregojë nëse Shqipëria mund të përparojë më tej me rritjen e aksesit së pakicave në media. Çdo progres në këtë drejtim do të jetë një manifestim i pjekurisë demokratike.

Progres në Mbrojtjen Legjislative dhe Institucionale Kundër Diskriminimit

Pajtueshmëria me [Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut \(ECHR\)](#) është një kërkesë thelbësore e [Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit \(SAA\)](#), e nënshkruar në vitin 2006 midis Shqipërisë edhe Bashkimit Evropian. Edhe pse të drejtat e

pakicave nuk përmenden drejtëpërdrejt, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut përmban një nen kundër diskriminimit sipas të cilit mohimi i të drejtave të pakicave në rrethana të caktuara mund të konsiderohet si diskriminim i ndaluar prej saj. Mbrojtja legjislative dhe institucionale kundër diskriminimit në Shqipëri është gjithashtu pjesë e reformave të kërkuara nga Komisioni Evropian. Miratimi, në Shkurt të vitit 2010, i [Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#), i cili është në përputhje me 4 direktivat Evropiane në fushën e mos-diskriminimit, solli Shqipërinë në përputhje me kërkesat ekzekutive të Brukselit. Ligji ndalon diskriminim racor, etnik, nacional ose fetar në fusha të ndryshme si punësimi, shëndetësia, arsimit, mirëqenia, dhe strehimi, si dhe gjithashtu përcakton bazën ligjore për procedurat që duhen ndjekur kur konstaktohen shkelje të dispozitave të tij. Megjithatë, problemi kryesor në Shqipëri nuk është mungesa e ligjeve cilësore por zbatimi i tyre në praktik. Si rezultat, hendeku midis të drejtave të njohura nga ligji dhe gëzimit në mënyrë efektive në praktik ka ndikuar negativisht kohezionin social të vendit. Për të trajtuar përjashtimin social dhe diskriminimin, ju desh autoriteteve shqiptare të adoptonin politika më të mira implementimi dhe të forconin kapacitetet e institucioneve përkatëse.

Në këtë kontekst, autoritetet zgjodhën, në Prill të vitit 2010, [Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#) si një institucioni për transpozimin, zbatimin dhe forcimin e ligjit kundër diskriminimit. Komisioneri është i autorizuar, së bashku me gjykatat, të shqyrtojë ankesat e individëve, të kryejë hetime administrative, të vendosë sanksione, si dhe të përfaqësojë akuzën para organeve gjyqësore në çështje civile ([Opinioni i Dytë i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s](#), f.13). Komisioneri gjithashtu mund të rekomandojë autoritetet përkatëse për nevojën e miratimit të ligjeve të reja si dhe për reformën e legjislacionit ekzistues. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe [Avokati i Popullit](#) vazhdojnë të jenë dy institucionet më kryesore të cilat luajn një rol aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat që i përkasin pakicave. Të dyja institucionet përballen me sfida shumë të rëndësishme si zbatimi efektiv i rekomandimeve të tyre nga administrata publike, i cili aktualisht mbetet në nivele jo të kënaqshme, si dhe forcimi i kapaciteteve të të dyja institucioneve për të zbatuar më mirë shkëlqet e të drejtave të pakicave ([Raporti i Progresit për Shqipërinë 2019](#), f.8).

Në përgjithësi, diskriminimi nuk shihet të jetë një problem kryesor në shoqërinë shqiptare. Megjithatë, ekzistojnë disa ankesa nga persona që i përkasin pakicave kombëtare për diskriminim në disa fusha të ndryshme, nga punësimi deri te arsimit, strehimi, shërbimet sociale, si dhe aksesit në skemat e shpërndarjes së pronave. Në vitin 2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi trajtoi një numër të lartë rastesh diskriminimi (205 raste të trajtuara, kundër 173 rasteve në 2017-ën), nga të cilat 179 ishin ankesa dhe tetë ishin çështje ex-officio. Në të njëjtin vit janë shqyrtuar 43 raste me pretendim diskriminimi për shkak të racës. Vetëm në 6 raste u dha vendim me diskriminim ([Raporti Vjetor 2018 i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#), f.38). Megjithatë, ky numër mund të mos pasqyrojë gjendjen reale në terren pasi një numër i konsiderueshëm i personave që i përkasin pakicave, sidomos ata që jetojnë në zona rurale dhe të largëta, nuk janë të vetëdijshëm për ekzistencën e Komisionerit si institucion dhe nuk janë në gjendje të përfitojnë nga mundësitë që ofron. Është indikativ fakti që ueb-faqja zyrtare e komisionerit nuk është e përkthyer në asnjë nga gjuhët e pakicave të njohura zyrtarisht. Anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian nuk janë të mirë informuar për rrugët ligjore që i mbrojnë ata nga çdo llojë diskriminimi, ndërsa diskriminimi i strukturuar që nuk i referohet një individit por të gjithë grupit ose komunitetit vazhdon të ekzistojë në nivele të larta kundër këtyre dy komuniteteve. Qeveria shqiptare është i vetmi lojtar që mund të rris funksionalitetin dhe efikasitetin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Hapja e degëve lokale në Shkodër dhe Korçë është hapi i duhur drejt këtij drejtimi.

*Komuniteti Rom dhe Egjiptian:
Pakicat më të Margjinalizuara dhe më të
Përfshijtura nga Shoqëria në Shqipëri*

Situata e pakicave rome dhe egjiptiane mbetet një problem i pazgjidhur dhe urgjent në Shqipëri ([Opinioni i Tretë i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s](#), f.2). Këto dy komunitete vazhdojnë të jenë grupet më të margjinalizuara dhe më të përjashtuara nga shoqëria me diskriminim të përhershëm në fushat e arsimit, punësimit, strehimit, shëndetësisë dhe regjistrimit në gjendjen civile ([Raporti i Progresit për Shqipërinë 2016](#), f.68). Progresi Raporti i vitit 2019 përshkruan me qartësi situatën dhe kushtet e jetesës së pakicave rome dhe egjiptiane në Shqipëri.

Faktet rreth situatës dhe kushteve të jetesës së pakicave rome dhe egjiptiane në Shqipëri bazuar në Raportin e Progresit të vitit 2019	
Edukimi	Vitet e fundit, në përgjithësi, ka pasur një prirje pozitive në fushën e arsimit në Shqipëri. Zhvillim pozitiv ka patur në regjistrimin e fëmijëve rom të moshës 7-15 vjeç në arsimin e detyrueshëm (aktualisht në 66%), si dhe në përfundimin e arsimit të detyrueshëm nga romët (43%). Megjithatë, hendeku midis aksesit të fëmijëve rom dhe egjiptian në arsim dhe fëmijëve të tjerë që jetojnë në të njëjtat zona mbetet i madh. Segregimi midis pakicave dhe shumicës ekziston akoma nëpër institucionet arsimore. Shqipëria vazhdon të ketë një nga nivelet më të ulëta të përfundimit të arsimit të detyrueshëm në rajon (44%).
Punësimi	Punësimi dhe fuqia punëtore e romëve mbeten shumë të ulëta (mbi 56% e romëve në moshë pune janë të papunë). Punësimi jo formal i romëve përbën 62% të punësimit të përgjithshëm rom.
Strehimi	Romët jetojnë kryesisht në vendbanime jo formale të karakterizuara nga kushte të pasigurta dhe jo të shëndetshme, pa akses në kushtet bazë të strehimit si furnizimi me ujë dhe drita. Shqipëria është ende vendi me shkallën më të ulët të aksesit të komunitetit rom në ujë të pishëm (46%) dhe energji elektrike (84%). Ligji i ri për strehimin shoqëror, i miratuar nga parlamenti në Maj të vitit 2018, adreson disa nga mangësitë në fushën e strehimit dhe dëbimit të detyruar. Ligji parashikon që një kuotë prej 5% të sigurohet për anëtarët më vulnerabël të pakicave rome dhe egjiptiane. Në vitin 2018, 424 familje rome përfituan nga projekte të ndryshme për përmirësimin e kushteve të strehimit (508 në vitin 2017).
Shëndeti	Sigurimi shoqëror për romët mbetet i ulët në Shqipëri dhe diferencat midis komunitetit romë dhe shumicës së popullsisë vazhdojnë të jenë të larta. Shumica e romëve dhe egjiptianëve nuk kanë akses në shërbimet shëndetësore për shkak të procedurave të ndërlikuara për marrjen e kartave shëndetësore.
Regjistrimi Civil	Romët dhe Egjiptianët përballen me pengesa direkte dhe indirekte në përdorimin e shërbimeve publike, të cilat rrjedhin nga mos përmbushja e kushteve të pranueshmërisë, nga mungesa e informacionit ose të kuptuarit të procedurave administrative, si dhe nga stigma dhe sjellja diskriminuese nga ana e popullsisë së përgjithshme. Ndryshimet në ligjin e regjistrimit civil të miratuar në Tetor të vitit 2018 kanë lejuar regjistrimin e një numri të konsiderueshëm fëmijësh rom të cilët ishin të paregjistruar në regjistrat e gjendjeve civile. Regjistrimi i romëve në regjistrat e gjendjeve civile është përmirësuar, por nevojiten përpjekje të mëtejshme, sidomos për të lehtësuar transferimin e regjistrimit midis bashkive të ndryshme dhe për të siguruar regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë vendit të cilët rrezikojnë të ngelen pa nënshtrësi.

Përmirësimi i kushteve të jetesës së pakicave rome dhe egjiptiane mbetet një nga sfidat më kryesore të Shqipërisë për të përmbushur një nga prioritetet kyçe drejt mbrojtjes të së drejtave të njeriut. Duke i dhënë përparësi trajtimit të kushteve të rënda ekonomike dhe sociale të romëve dhe egjiptianëve, autoritetet shqiptare miratuan, në Dhjetor të vitit 2015, [Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020](#). Ky dokument i qeverisë shqiptare përfshin politika specifike të cilat synojnë në rritjen e aksesit të pakicave rome dhe egjiptiane në shërbimet sociale përmes eliminimit të barrierave, në ofrimin e një arsimit gjithëpërfshirës, e një shëndetësi më të mirë dhe në rritjen e mirëqenies përmes punësimit formal, si dhe në përmirësimin e kushteve të strehimit.

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020		
Fushat e Politikës	Qëllimet Strategjike	Objektivat e Politikës
Akses i barabartë në rregjistrimin civil dhe në drejtësi	Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të rregjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët. Synimi: Në fund të vitit 2020, 100% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civile.	Objektivi 1: Ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të komunitetit Rom dhe Egjiptian me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile. Objektivi 2: Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi si dhe referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e rasteve të trafikuar.

<p>Arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor</p>	<p>Romët dhe egjiptianët të gëzojnë akses dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.</p> <p>Synimi: Në fund të vitit 2020, 70% më shumë djem dhe vajza të komunitetit Rom dhe Egjiptian arrijnë të përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit dhe 100% përfundojnë arsimin parashkollor.</p>	<p>Objektivi 1: Më shumë djem dhe vajza rome dhe egjiptiane që përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit.</p> <p>Objektivi 2: Promovimi i dialogut ndërkulturor dhe mirëkuptimit të përbashkët përmes zhvillimit të komuniteteve mbi bazë shkolle.</p> <p>Objektivi 3: Të forcohet bashkëveprimi i shkollës me shërbimet sociale, për adresimin e rasteve të fëmijëve romë dhe egjiptianë me probleme sociale-ekonomike.</p> <p>Objektivi 4: Promovimi i njohjes së identitetit Rom dhe atij Egjiptian si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.</p>
<p>Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP)</p>	<p>Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve.</p> <p>Synimi: 80% me shume gra dhe burra romë dhe egjiptianë të cilët marrin pjesë në AFP dhe programet aktive të punësimit do të integrohen në tregun e punës deri në fund te vitit 2020.</p>	<p>Objektivi 1: Integrimi i romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës nëpërmjet AFP-së dhe programeve aktive të punësimit.</p> <p>Objektivi 2: Nxitja e sipërmarrjes (sociale) dhe vetëpunësimit i romëve dhe egjiptianëve.</p> <p>Objektivi 3: Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i performancës së punës së punonjësve të zyrave të punësimit dhe të sistemit të arsimit dhe formimit profesional, për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës.</p>
<p>Kujdesi Shëndetësor</p>	<p>Garantimi i një kujdesi mjekësor të aksesueshëm, të përbalueshëm dhe të barabartë për romët dhe egjiptianët.</p> <p>Synimi: 100% e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian do të kenë mundësi të përdorin shërbimet bazë shëndetësore deri në fund të vitit 2020.</p>	<p>Objektivi 1: Rritja e numrit të romëve dhe egjiptianëve që përdorin shërbimet bazë shëndetësore.</p> <p>Objektivi 2: Përmirësimi i informimit dhe promovimit shëndetësor për shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor për romët dhe egjiptianët.</p>
<p>Strehimi dhe Integrimi urban</p>	<p>Përmirësimi i kushteve të strehimit për romët dhe egjiptianët.</p> <p>Synimi: 80% e familjeve Rome dhe Egjiptiane, të cilët kanë inicuar procedurat e legalizimit, i kanë përfunduar ato suksesshëm deri në fund të vitit 2020.</p>	<p>Objektivi 1: Përmirësimi i mekanizmave që do të ndikojnë në lehtësimin e familjeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian për procedurat e legalizimit.</p> <p>Objektivi 2: Më shumë familje rome dhe egjiptiane të përfshira në programet e strehimit direkt dhe indirekt.</p>
<p>Mbrojtja Sociale</p>	<p>Rritja e aksesit në programet e mbrojtjes sociale për anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian.</p> <p>Synimi: 65% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të jenë të përfshirë në programet e mbrojtjes sociale deri në fund të vitit 2020.</p>	<p>Objektivi 1: Përmirësimi i përfshirjes së anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në programet e mbrojtjes sociale.</p> <p>Objektivi 2: Nxitja/ndërtimi i programeve për riintegrimin me fokus forcimin e familjes dhe riintegrimin në punë.</p> <p>Objektivi 3: Riintegrimi në shoqëri i familjeve që qëndrojnë në Qendrën Tranzitore të Emergjencave.</p>

Autoritetet shqiptare kanë krijuar një sistem elektronik të mbledhjes së të dhënave (ROMALB), i cili përdoret nga qeveritë lokale për të monitoruar zbatimin e politikave të përfshira në planin e veprimit. Edhe pse funksional, ky mekanizëm nuk ka arritur të forcojë zbatimin e politikave, por u ka lejuar autoriteteve të kenë një ide mbi progresin e bërë në disa nga qëllimet strategjike. Një risi tjetër e këtij plani strategjik është angazhimi i shtetit shqiptar për të alokuar fonde publike për zbatimin e tij. Konsiderohet se zbatimi i planit strategjik kërkon shpenzime prej gati 56 million euro, nga të cilat 55 përqind do të sigurohen nga buxheti i shtetit kurse pjesa tjetër nga donatorë të huaj. Megjithatë, mbështetja e lartë në fondet e jashtme mund të minojë rolin kryesor të institucioneve në procesin e zbatimit të planit strategjik. Qasjet jo-legale të detyrueshme të ndërhyrjes shtetërore, siç është ky plan veprimi, kanë bërë që disa aktorë të

shoqërisë civile të kenë rolë kryesorë në procesin e implementimit. Ky nuk mund të konsiderohet si një zhvillim negativ, por varësia e tepërt e disa organizatave të shoqërisë civile nga fondet e BE-së dhe Kombeve të Bashkuara kanë çuar në "vetëpërbajtje" në lidhje me rolin e tyre që synon në ruajtjen e përshtatshmërisë të veprimeve të qeverisë me detyrimet dhe angazhimet që rrjedhin nga plani i veprimit.

Zbatimi i qëllimeve strategjike që do të përmirësojnë situatën e pakicave rome dhe egjiptiane është një nga kushtet që Shqipëria duhet të përmbush në rrugën e saj drejt integritimit në BE. Proçesi i Berlinit dhe strategjia e re e zgjerimit i kanë dhënë vëmendjen e merituar dhe të nevojshme pakicës rome. Zhvillimi më i rëndësishëm politik në këtë drejtim është miratimi i [Deklaratës të Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve gjatë Proçesit të Zgjerimit të BE-së](#) që synon të gjejë zgjidhje për problemet ekonomike dhe sociale të komunitetit rom. Shqipëria e ka nënshkruar deklaratën, e cila i shton axhendës qeveritare një sër detyrimesh tjetra. Qeveria shqiptare duhet të përqendrojë punën e saj në përmbushjen e objektivave që rrjedhin si nga Plan i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane ashtu edhe nga Deklarata për Integrimin e Romëve si Pjesë e Proçesit të Zgjerimit të BE-së. Çdo vonesë në formimin e mekanizmave implementues do të vëjë në dyshim premtimet për përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të të dy dokumentave të cilat janë jo-ligjërish të detyrueshme.

Objektivat e Deklaratës për Integrimin e Romëve si Pjesë e Proçesit të Zgjerimit të Ballkanit Perëndimor	
Punësimi	Rritja e shkallës së punësimit të romëve në sektorin publik në shkallën proporcionale të pjesëmarrjes të romëve në popullsinë e përgjithshme; Rritja e shkallës së punësimit midis romëve të paktën 25%;
Strehimi	Kudo që të jetë e mundur, të legalizohen të gjitha vendbanimet joformale ku jetojnë Romët; ose të sigurohet strehim i përhershëm, i mirë, i përballueshëm dhe jo të segreguara për Romët që aktualisht të jetojnë në vendbanime joformale që nuk mund të legalizohen për arsye të justifikuara;
Edukimi	Rritja e nivelit të regjistrimit dhe përfundimit të arsimit fillor të romëve në 90%, dhe regjistrimi dhe shkalla e përfundimit të arsimit sekondar të romëve në 50%;
Shëndeti	Sigurimi i mbulimit universal të sigurimit shëndetësor të romëve të paktën 95% ose me normën e barabartë për pjesën tjetër të popullatës;
Regjistrimi Civil	Të sigurohet që të gjithë romët të regjistrohen në regjistrat civilë;
Mosdiskriminimi	Të forcohen strukturat e qeverisë për të mbrojtur kundër diskriminimit dhe të vendoset një nën-divizion specifike për mosdiskriminimin e romëve brenda organeve zyrtare të mosdiskriminimit për të përpunuar ankesat nga romët, të ofrojnë mbështetje ligjore për viktimat dhe të identifikohen skemat e diskriminimit, përfshirë diskriminim institucional dhe të fshehur;

Nga vlerësimi i raporteve të progresit, mund të konstatohet se në Shqipëri ekziston një farë progresi, por në të njëjtën kohë, edhe mungesë progresi përsa i përket mbrojtjes të së drejtave të pakicave. Reforma e përgjithshme e sistemit të mbrojtjes së pakicave kombëtare ende konsiderohet e paplotë. Krahasimi i raporteve të progresit zbuloi një farë përparimi të kufizuar në disa ndryshime ose përmirësime ligjore. Por progresi në çështjet më thelbësore siç është arsimit në gjuhën e pakicave ose përdorimi i gjuhëve të pakicave mbetet ende i ngadaltë. Konkluzioni i përgjithshëm është se Shqipëria ka demonstruar një angazhim të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, por reformat në këtë sektor janë të ngadalta për shkak të mungesës së vullnetit politik. Ligjet e miratuara injorohen shumë herë nga hartuesit e politikave. Duket se kushtëzimi politik i BE-së nuk sjellë reforma në Shqipëri pa prezencën e një mjedisi të brendshëm, i gatshëm për të gjetur konsensus mbi problemet e vendit, ndërsa performanca e dobët e strukturave shtetërore konsiderohet si pengesa më kryesore për thellimin e reformave në vend.

Si rregul, çdo raport progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë pasohet nga dy deklarata politike të kundërta. Nga njëra anë, qeveria deklaron në mënyrë solemne se progresi raporti "do të formojë programin e punës së qeverisë për vitet e ardhshme" duke pretenduar se Komisioni ka njohur arritjet e qeverisë gjate viteve të kaluara. Nga ana tjetër, opozita "përsëritet raportin progresin si një imazh realist i dështimit të qeverisë", por nuk shkon më tej në përmbushjen e rolit natyror të një opozite politike që ka si mision sigurimin e përgjegjshmërisë së qeverisë. Ky qëndrim çon në konkluzionin se elita politike shqiptare ka ndjekur orientimin drejt Evropës jo për shkak të motiveve ideologjike, por e përdorin atë si kartën e tyre më të fortë për tu ngjitur në pushtet. Tranzicioni shqiptar është shënuar nga një luftë e vazhdueshme dhe shkatëruese për pushtet midis forcave politike, kundër modelit të vërtet të demokratizimit. Prandaj, është e vështirë për shtetin shqiptar të arrijë nivelin e demokracisë që ekziston në botën perëndimore. E gjithë kjo sugjeron se krijimi i një sistemi mbrojtës për të drejtat e pakicave në Shqipëri do një kohë të gjatë për të funksionuar sipas standarteve ndërkombëtare.

Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare: Një Ligj me Dy Aspekte të Kundërta

Në Tetor të vitit 2017, Parlamenti shqiptar miratoi [Ligjin \(96/2017\) për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare](#), i cili aktualisht përbën ligjin themelor që rregullon statusin dhe të drejtat e pakicave kombëtare në Shqipëri. Miratimi i këtij ligji përbën një risi në procesin e hartimit të politikave minoritare në Shqipëri. Deri në vitin 2017 nuk ekzistonte ndojë kornizë ligjore specifike për mbrojtjen e pakicave. Të drejtat e minoriteteve ishin të përcaktuara në ligje të ndryshme të sistemit ligjor të vendit, duke lejuar një sërë mangësish në njohjen e pakicave si dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Sqarimi i pozicionit të politikës shqiptare kundrejtë pakicave dhe përfshirja e standarteve evropiane për mbrojtjen e minoriteteve në sistemin e brendshëm ligjor kërkonin adresim specifik dhe sa më të shpejt. Autoritetet shqiptare iu përgjigjën kësaj domosdoshmërie përmes miratimit të një ligji që rregullon si statusin e pakicave kombëtare, ashtu dhe të drejtat e tyre.

Për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar ky ligj përfshin një definicion i cili përjashton mospërputhjet në kriteret ligjore të kërkuara për njohjen e statusit të pakicave. Sipas definicionit, legjislativi shqiptar njihet zyrtarisht nëntë pakica, grekët, arumunët, romët, serbët, malazezët, të njohur si pakica edhe më parë por pa asnjë bazë ligjore, si dhe boshnjakët, bullgarët dhe egjiptianët të cilët u njohën si pakica kombëtare për herë të parë me ligjin e ri. Ligji i ri jo vetëm përfshin definicionin ligjor dhe rendit grupet që gëzojnë statusin e pakicave kombëtare, por gjithashtu përcakton dhe procedurën e njohjeve të ardhshme duke mos lënë boshllëqe për sa i përket përfitimit të statusit të pakicave. Gjithashtu, ligji eliminon ndarjen midis kategorive të "pakicave kombëtare" (një status i gëzuar më parë nga pakicat greke, maqedonase, malazeze dhe serbe) dhe të "pakicave gjuhësore" (një status i gëzuar më parë nga pakicat rome dhe arumune). Ky diferencim ishte konsideruar nga Komiteti Këshillëdhënës i FCNM-s si problematik sepse mund të shkaktonte trajtim jo të barabartë të të drejtave të një grupi në krahasim me tjetrin. Ligji i ri përfshin të gjitha grupet minoritare në një kategori, të asaj të pakicave kombëtare, duke përjashtuar çdo diskriminim në bazë të statusit të tyre.



Komiteti Këshillëdhënës i Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve (FCNM) e konsideron si problematik kriterin e shtetësisë. Konsideron se një hap i tillë nuk është në përputhje me përpjekjet aktuale që synojnë në zhvillimin e një qasjeje më të nuancuar për përdorimin e kriterit të shtetësisë në mbrojtjen e pakicave kombëtare. Komiteti Këshillëdhënës konsideron se ndërsa shtetësia mund të jetë një kërkesë e ligjshme në fusha si përfaqësimi në Parlament, zbatimi i përgjithshëm i këtij kriteri mbetet problematik në lidhje me fusha tjetra të rëndësishme të përfshira në Konventën Kuadër, siç janë mosdiskriminimi dhe barazia, si dhe të drejtat kulturore dhe gjuhësore.

Ligji i ri përmban gjithashtu parimin e vetidentifikimit të lirë. Neni 6 i ligjit jo vetëm njeh të drejtën e çdo personi të deklarojë përkatësinë e tij në një pakicë kombëtare, por në të njëjtën kohë i lejon çdo personi që i përket një pakice kombëtare të zgjedhë lirshëm të trajtohet ose të mos trajtohet si i tillë duke i dhënë gjithë procesit dy dimensione, dimensionin e identifikimit dhe dimensionin e deklaramit të lirë. Mbetet për të parë se si kjo dispozitë do të zbatohet në praktikë. Shqipëria ka një të kaluar problematike në lidhje me zbatimin e parimit të vetidentifikimit kryesisht përmes praktikës së regjistrimit të detyrueshëm të kombësisë në certifikatat e lindjes, një praktikë e braktisur në vitin 2011, dhe presionit ndaj individëve në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 për t'u përgjigjur pyetjes mbi origjinën etnike në përputhje me të dhënat e regjistruara në regjistrin civil. Autoritetet shqiptare vendosën gjopa për përgjigjet e gabuara mbi origjinën etnike si një praktikë për të shmangur rritjen artificiale të popullsisë së pakicës greke në jug për shkak të mobilizimit të shtetasve shqiptar me prejardhje etnike që jetojnë në Greqi. Pyetja është nëse qeveria shqiptare mund të mbijetojë sfidave të ardhshme, përfshirë këtu organizimin e regjistrimit të popullsisë së vitit 2020 pa ndonjë ndërhyrje apo presion që mund të ndikojë në deklaramin e lirë të origjinës së çdo personi. Mbledhja e të dhënave të besueshme bazuar në të drejtën e vetidentifikimit është një aspekt i rëndësishëm i ligjit të ri (neni 7) pasi disa nga të drejtat e pakicave kushtëzohen nga një prag demografik ose nga një numër i konsiderueshëm i pakicave që jetojnë në një zonë të veçantë.

Një aspekt tjetër pozitiv i ligjit të ri është fakti që ai braktisë zyrtarisht konceptin e vjetër të "zonave minoritare". Kufizimet territoriale për mbrojtjen e pakicave kanë një rëndësi të madhe në Shqipëri për shkak të trashëgimisë komuniste që kufizonte gëzimin e të drejtave të minoriteteve në zonat ku pakicat jetonin më të përqëndruara. Qeveria shqiptare nuk pranon ekzistencën e kufizimeve të tilla, por në opinion e dytë për Shqipërinë, Komiteti Këshillëdhënës i FCNM-s pranon ekzistencën de facto të "zonave

minoritare” duke deklaruar se “në Shqipëri është identifikuar se personat që i përkasin pakicave dhe jetojnë jashtë zonave minoritare nuk gëzojnë të njëjtat të drejta me ata që jetojnë në zona të tilla”. Ligji i ri trajton këto kufizime duke deklaruar se pakicat kombëtare mund të ushtrjnë të drejtat dhe të gëzojnë liritë e garantuara me ligj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 5).

Megjithatë, rreziku dy të drejtat më të rëndësishme të minoriteteve, e drejta për arsim dhe e drejta për përdorimin e gjuhëve të pakicave, të mbeten të kufizuara territorialisht është i lartë për shkak të pragut 20 përqind që duhet të llogaritet në lidhje me popullsinë e secilës prej 61 bashkive. Kjo dispozitë përbën një pengesë të pakapërcyeshme për aksesin efektiv në të drejtat arsimore dhe gjuhësore, sidomos nëse marim parasysh faktin që popullsia që i përket të njëjtës pakicë kombëtare është ndarë në dy njësi territoriale, si rezultat i ndarjes së re administrative dhe territoriale. Si pasojë, personat që i përkasin pakicave kombëtare dhe jetojnë në njësi të tilla lokale nuk do të jenë në gjendje të gëzojnë të drejtat e tyre arsimore dhe gjuhësore pasi pragu i 20 përqind nuk mund të përmbushet ([Opinion i Tretë i Komitetit Këshillëdhënës i FCNM-s](#), f.24). Ligji ja lë detajet e zbatimit të këtyre dispozitave Këshillit të Ministrave i cili sipas nenit 23 ka detyrimin të aprovojë të gjitha aktet ligjore shtesë.

Varshmëria e zbatimit të ligjit nga vendimet e Këshillit të Ministrave, si dhe nga legjislati përkatesë sektorial konsiderohet si një disavantazh që pengon vetë-ekzekutimin e normave të tij dhe vonon zbatimin e drejtëpërdrejt të të drejtave të përcaktuara në ligj. Në dymbëdhjetë segmente të ligjit, zbatimi i dispozitave të tij varet nga miratimi i vendimeve përkatesë të Këshillit të Ministrave, ndërsa zbatimi i një neni varet nga aktet ligjore të miratuara nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ). Deri në Gusht të vitit 2019 (gati dy vjet pasi ligji hyri në fuqi), Këshilli i Ministrave kishte miratuar vetëm gjashtë akte ligjore, shumë larg qëllimit të vendosur në nenin 23 të ligjit (gjashtë muaj nga hyrja në fuqi). Kjo vonesë është parë me shqetësim nga Komisioni Evropian i cili i kërkon Shqipërisë të “miratojë sa më shpejt paketën e plot të legjislatit sekondar për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e pakicave” ([Raporti i Progresit për Shqipërinë 2019](#), f.30). Mos miratimi i legjislatit sekondar i bën disa nga segmentet e ligjit jo efektiv, duke lënë në akull një numër të drejtash të rëndësishme të pakicave (shih tabelën më poshtë).

	Dispozitat që Varen nga Legjislati Sekondar ose Sektorial Përkatesë	Aktet Ligjore të Adoptuara deri në Gusht të Vitit 2019
1. X	Neni 4, Pika 3: Kërkesa për njohjen e pakicave kombëtare shqyrtohet nga një komision ad hoc, i cili ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme. Struktura dhe funksionet e komisionit, si dhe procedurat për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.	Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar ndonjë vendim në lidhje me këtë dispozitë ende.
2. X	Neni 7, Pika 2: Kriteret, dokumentacioni, si dhe procedurat përkatesë në lidhje me mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që i përkasin pakicave kombëtare miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për punët e brendshme.	Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar ndonjë vendim në lidhje me këtë dispozitë ende.
3. ✓	Neni 11, Pika 3: Masat dhe politikat e nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për fushat e lartpërmendura.	Në korrik të vitit 2019 , Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 462 për miratimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në Shqipëri të personave që u përkasin pakicave kombëtare. Vendimi garanton pjesëmarrje të barabartë të pakicave kombëtare dhe i bën thirrje Ministrisë së Kulturës të marrë masat e nevojshme për pjesëmarrjen e minoriteteve në jetën kulturore dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore përmes financimit të projekteve specifike.

4.	<p>Neni 12, Pika 3: Strategjitë, programet dhe planet e veprimit për të krijuar kushtet e nevojshme që pakicat kombëtare të ruajnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për arsimin dhe kulturën.</p>	<p>Në Korrik të Vitit 2019, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 463 për përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur e zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë dhe gjuhën e tyre. Vendimi sqaron se Ministria e Kulturës dhe Ministria e Arsimit janë përgjegjëse për zhvillimin e strategjive të nevojshme për mbrojtjen e identitetit të pakicave kombëtare në konsultim të plotë me anëtarët e pakicave dhe përfaqësuesit e tyre.</p>
5.	<p>Neni 13, Pika 3: Kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për arsimin dhe çështjet vendore.</p>	<p>Vendimi i Këshillit të Ministrave i cili do të përcaktojë kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku mund të themelohen shkollat e pakicave kombëtare, "numri i konsiderueshëm" dhe "kërkesat adekuate" nuk është miratuar ende. Mungesa e këtij legjislacioni sekondar bllokoi krijimin e klasave në gjuhët e pakicave.</p>
6.	<p>Neni 13, Pika 4: Masat e përshtatshme në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor, me qëllim nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare dhe të shumicës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.</p>	<p>Në Shtator të vitit 2018, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 562 për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë. Vendimi kërkon nga institucionet publike të arsimit të lartë të përfshijnë në aktivitetet e tyre mësimdhënien, njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe fesë së pakicave kombëtare. Financimi i këtyre veprimtarive do të mbulohej nga buxheti i institucioneve që do të ndërmarrin nismat përkatëse.</p>
7.	<p>Neni 13, Pika 5: Masat e përshtatshme për krijimin e mundësive dhe kushteve për pajisjen me tekste shkollore, formimin fillestar, trajnimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.</p>	<p>Në Shtator të vitit 2018, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 561 për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare. Sipas Vendimit, nisma për funksionimin e klasave mund të merret nga a) njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, b) Njësia arsimore vendore përkatëse, dhe nga c) komuniteti i zonës, ku pritet të hapen klasa të pakicave kombëtare. Në mënyrë që klasa të jetë funksionale, numri i studentëve nuk duhet të jetë më i vogël se 15. Librat shkollore dhe trajnimi i mësuesve financohen nga buxheti i shtetit.</p>
8.	<p>Neni 15, Pika 4: Në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat, që u përkasin pakicave kombëtare, përbëjnë mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj njësie, ata kanë të drejtë të marrin informacion, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën e pakicës, mbi zhvillimin e procesit zgjedhor. Dhënia e informacioneve në gjuhën e pakicave për zhvillimin e procesit zgjedhor rregullohet me akte të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).</p>	<p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk ka miratuar ndonjë akt ligjor për të siguruar informacionin e pakicave kombëtare në gjuhët e tyre mbi procesin zgjedhor, edhe pse në Qershor të vitit 2019 u mbajtën zgjedhjet lokale në Shqipëri. Megjithatë, një muaj para zgjedhjeve, KQZ dhe Komiteti për Pakicat Kombëtare nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim komunikimin dhe shkëmbimin e të dhënave në lidhje me njësitë e qeverisjes vendore ku pakicat kombëtare përbëjnë më shumë se 20 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë, si dhe të informojnë pakicat kombëtare për procesin zgjedhor përmes prodhimit materialeve informuese, arsimore dhe ndërgjegjësuere të përkthyer në gjuhët e pakicave kombëtare.</p>
9.	<p>Neni 15, Pika 6: Mënyra e përdorimit të gjuhës së pakicave rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrave përgjegjës për punët e brendshme dhe çështjet vendore.</p>	<p>Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar ndonjë vendim në lidhje me këtë dispozitë ende.</p>
10.	<p>Neni 18, Pika 2: Organizimi, funksionimi dhe niveli i pagave i anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare dhe personelit administrativ përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit.</p>	<p>Në Dhjetor të Vitit 2018, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 726 për organizimin dhe funksionimin e komitetit për pakicat kombëtare. Vendimi përcakton statusin e Komitetit si një person juridik, publik, buxhetor, në varësi të Kryeministrit. Komiteti për Pakicat Kombëtare ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave dhe interesave të pakicave kombëtare në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Përbërja dhe struktura e Komitetit miratohet</p>

		nga Kryeministri në përputhje me legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e administratës publike. Duket se Komiteti do të jetë një organ i kontrolluar totalisht nga Zyra e Kryeministrit.
✓	11. Neni 20, Pika 4: Përzgjedhja e kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të Komitetit për Pakicat Kombëtare (KPK) bëhet nëpërmjet një procesi të pavarur, transparent dhe gjithëpërfshirës. Procedurat dhe rregullat për zhvillimin e këtij procesi rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga Kryeministri.	Në Maj të vitit 2019, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin Nr. 286 për miratimin e procedurave të përzgjedhjes së kryetarit, nënkryetarit dhe anëtarëve të komitetit për pakicat kombëtare. Përzgjedhja e kandidatave për kryetarin, nënkryetarin dhe anëtarët e KPK-së kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurave të hapura e publike të konkurrimit, nga Kryeministria. Kandidatët për pozicionin e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit duhet t'i përkasin pakicave kombëtare dhe të përmbushin një numër kriteresh. Vendimi nuk sqaron se çfarë do të ndodhë nëse kandidatët që u përkasin pakicave nuk i plotësojnë kriteret për zgjedhjen e tyre. Personat që i përkasin pakicave kombëtare mund të aplikojnë si anëtar të Komitetit individualisht ose organizatat që përfaqësojnë pakicat mund të rekomandojnë kandidatët e tyre.
X	12. Neni 21, Pika 3: Krijohet fondi për pakicat kombëtare për mbështetjen e nismave dhe projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, Kriteret për mbështetjen e nismave dhe projekteve, kriteret e përzgjedhjes për financimin e tyre dhe administrimi i fondit për pakicat kombëtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.	Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar ndonjë vendim në lidhje me këtë dispozitë ende.

Sipas tabelës së mësipërme, ligji për mbrojtjen e pakicave kombëtare mund të konsiderohet një ligj me dy aspekte të kundërta. Nga njëra anë, ligjvënësit kanë përcaktuar me qartësi të drejtat e pakicave kombëtare duke shmangur formulimet e paqarta. Nga ana tjetër, ata e kanë vendosur zbatimin e këtyre të drejtave nën kontrollin e Këshillit të Ministrave. Është në varësi të qeverisë shqiptare të tregojë ndjeshmërinë e nevojshme duke shmangur miratimin e ndonjë akti nënligjor që mund të çojë në kufizimin e të drejtave të njohura nga ligji. Disa parashikojnë që nëse vendimet e ardhshme të Këshillit të Ministrave kufizojnë disa nga të drejtat e pakicave kjo do të përbëjë një rrezik të madh për sistemin e mbrojtjes së pakicave kombëtare në Shqipëri dhe arritjeve të fituara gjatë viteve të fundit. Në një rast të tillë, spektri i vendosjes së Shqipërisë midis vendeve me sisteme të dobëta – apo edhe të dështuara – për mbrojtjen e pakicave, për fat të keq, do të jetë një skenar që nuk mund të përjashtohet dhe një rrezik i dukshëm për të ardhmen e vendit.

Komiteti për Pakicat Kombëtare: Ende në Ujëra Institucionale të Paqarta

Përkthimi i dispozitave të ligjit dhe të premtimeve politike të qeverive në veprime reale kërkon mekanizma efektive administrimi, organe të pavarura dhe performancë të fortë institucionale të strukturave shtetërore. Në Shqipëri, institucionet e pavarura janë ende të pakta. Ky është edhe rasti i Komitetit për Pakicat Kombëtare, i cili ende funksionon në ujëra institucionale të paqarta.

Autoritetet shqiptare krijuan Komitetin për Pakicat Kombëtare në vitin 2004 me detyrë përmirësimin e mbrojtjes së pakicave të vendit. Edhe pse Komiteti ekziston në rendin shqiptar për më shumë se 10 vjet, nuk ka arritur të gjejë rolin e tij institucional, kryesisht për shkak të natyrës së tij komplekse. Nga njëra anë, është një organ qeveritar nën kujdesin e kryeministrit; nga ana tjetër, përfaqëson interesat e pakicave. Struktura dhe natyra e përzier e ka bërë këtë institucion të prekshëm nga ndërhyrjet politike, duke rezultuar në kontrollin e tij të plot nga ekzekutivi dhe në shndërrimin e tij nga një organ për mbrojtjen e minoriteteve, në një organ të dëmshëm për dialogun

midis autoriteteve dhe pakicave. Sidoqoftë, e kaluara problematike nuk eliminon rëndësinë e ekzistencës së tij. Përkundrazi, kërkon shndërrimin e tij në një organ përfaqësues të vërtet të pakicave kombëtare.

Ligji për mbrojtjen e pakicave parashikon krijimin e një komiteti të ri, i cili do të përbëhet nga përfaqësues të të gjithave pakicave të njohura zyrtarisht. Ky institucion do të themelohet si një organ këshillues, përgjegjës për të dhënë rekomandime mbi projektligjet, politikat dhe programet që lidhen me të drejtat e pakicave. Do të monitorojë zbatimin e ligjit dhe politikave shtetërore mbi pakicat kombëtare me detyrimin për të paraqitur raporte periodike në Kuvend duke analizuar situatën e pakicave në terren. Edhe pse Komiteti është përfshirë në ligjin e ri, funksionimi i tij duket se bazohet në të njëjtin model të vjetër ku formimi dhe funksionimi i Komitetit varet plotësisht nga Kryeministri dhe Këshilli i Ministrave. Vazhdon të jetë akoma një organ qeveritar që i përgjigjet drejtëpërdrejt zyrës së Kryeministrit. Kryeministri aprovon strukturën dhe emëron anëtarët e Komitetit, kryetarin dhe nënkryetarin, kurse Këshilli i Ministrave përcakton procesin e përzgjedhjes dhe organizimit të anëtarëve të Komitetit, përfshirë personelin që i bashkëngjitet.

Një segment shumë domethënës i ligjit të ri është dispozita që njeh kompetencën e Komitetit për të financuar nisma dhe projekte për mbrojtjen e pakicave përmes Fondit për Pakicat Kombëtare. Por përsëri, Këshilli i Ministrave përcakton kriteret për mbështetjen e nismave dhe projekteve, kriteret e përzgjedhjes për financim, si dhe kriteret për menaxhimin e Fondit. Vonesa e Këshillit të Ministrave në miratimin e legjislacionit sekondar përkatës nuk ka lejuar formimin e Komitetit të ri ende. Është për tu parë nëse Komiteti i ri do të jetë plotësisht funksional, një sfidë reale e cila do të duhet të arrihet shumë shpejt. Sfidat e tjera kryesore përfshijnë:

- Angazhimin i pamjaftueshëm politik që mund të vonojë formimin e Komitetit.
- Drejtimin e një procedure të pavarur dhe transparente për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit.
- Përfaqësimin e të nëntë pakicave kombëtare të njohura zyrtarisht në mënyrë të barabartë dhe kompozimin e ekuilibruar të Komitetit.
- Themelimin e një organi të pavarur në gjendje të flasë në emër të interesave të pakicave kombëtare.
- Ushtrimin e kompetencave të Komitetit pa asnjë ndërhyrje politike.
- Konkurrencën e lartë midis anëtarëve të pakicave të ndryshme brenda Komitetit.
- Qëndrueshmërin e pavarur financiare të Komitetit.

Sistemet e Mbrojtjes së Pakicave në Vendet e Ballkanit Perëndimor

Përsa i përket përputhjes së legjislacionit kombëtar me detyrimet rajonale dhe ndërkombëtare, shtetet e Ballkanit Perëndimor mund të ndahen gjerësisht në dy kategori. Duke pasur parasysh shpejtësinë e shndërrimit të detyrimeve kombëtare në legjislacionin e brendshëm, Bosnja Hercegovina (BiH), Serbia dhe Mali i Zi mund të renditen në kategorinë e shteteve më të shpejta dhe me gatishmëri më të madhe. Nga miratimi i Konvetës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve (FCNM), ju desh autoriteteve të këtyre shteteve më pak se tre vjetë për të formuluar dhe miratuar legjislacionin dedikuar pakicave kombëtare. Tri vendet e tjera, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut i përkasin kategorisë së shteteve të vonuara përsa i përket shndërrimit të detyrimeve të tyre ndërkombëtare në legjislacionin e brendshëm. Autoritetet e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut vonuan ndjeshëm (7 dhe 11 vjetë përkatësisht) në miratimin e

legjislacionit që trajton statusin dhe të drejtat e pakicave të tyre. Shqipëria ka vonuar më shumë në krahasim me fqinjët e saj. Edhe pse autoritetet shqiptare kishin ratifikuar FCNM-në që nga viti 1999, ju desh më shumë se 15 vjet për të miratuar një ligj gjithëpërfshirës për të drejtat e pakicave kombëtare bazuar në dispozitat e FCNM-s dhe rekomandimet e Komitetit Këshillëdhënës. Por, kur vlerësojmë vonesën e Shqipërisë në këtë drejtim, duhet të kemi parasysh se numri i popullsisë së pakicave kombëtare në Shqipëri është më i vogël në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe bashkëjetesa paqësore e shumicës me pakicën nuk konsiderohen si rrezik për stabilitetin e vendit. Prandaj dhe presioni i brendshëm dhe i jashtëm për miratimin e një ligji për pakicat në Shqipëri ishte më i vogël në krahasim me shtetet e tjera të rajonit. Megjithatë, kjo nuk justifikon vonesën e autoriteteve shqiptare.

Kornizat ligjore për mbrojtjen e minoriteteve janë prezente në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, vlerësimi i situatës në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor zbulon se pavarësisht përpjekjeve shumëvjeçare të cilat kanë përmirësuar infrastrukturën ligjore, pajtueshmëria me standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve dhe mosdiskriminimit mbetet akoma një sfidë reale. Kur bëhet fjalë për respektimin e të drejtave të pakicave, disa shtete janë më bujare, si Kosova që pavarësisht vonesës në miratimin e ligjit të pakicave ka legjislacionin më miqësor në lidhje me përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave, ndërsa disa shtete janë më pak bujare përse i përket të drejtave arsimore dhe gjuhësore si Bosnia dhe Mali i Zi. Të gjitha vendet e rajonit, përveç Kosovës, përdorin shtetësin si kriter për njohjen dhe përcaktimin e pakicave kombëtare. Kjo dispozitë është çështje shqetësuese në fushën e njohjes së pakicave pasi mund të përjashtojë personat me nënshtetësi të pa përcaktuar nga gëzimi i të drejtave të tyre. Një problem tjetër i përgjithshëm dhe në të njëjtën kohë një sfidë për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor është sigurimi i të dhënave statistikore të besueshme për numrin dhe situatën social-ekonomike të pakicave, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e politikave përkatëse.

Shumica e praktikave të ndërmara nga qeveritë në fushat në fjalë nuk kanë sjellë rezultate reale. Instrumentet aktuale ndërkombëtare dhe rajonale të monitorimit varen nga vullneti politik. Gjithashtu, mungojnë kompetencat për të kontrolluar punën e qeverive. Si rezultat, nuk monitorohet progresi mbi veprimet e ndërmara nga qeveritë pasi janë dhënë rekomandimet nga institucionet ndërkombëtare. Prandaj, mungesa e vullnetit politik për të adresuar shkeljet e të drejtave të pakicave mbetet një sfidë kryesore. Për më tepër, mos-përfaqësimi i pakicave dhe konkurrenca e lartë midis komuniteteve të ndryshme zvogëlon aftësitë e tyre për të bërë presion ndaj qeverive për njohjen e të drejtave të tyre, ndërsa efekti vetë-heshtës i shoqërisë civile dhe performanca e dobët e strukturave shtetërore përbëjnë një sfidë reale për të gjitha sistemet kombëtare të mbrojtjes së pakicave në Ballkanin Perëndimor.

	Shqipëria	Bosnia Herzegovina	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia	Kosova
Korniza e Legjislacionit Kombëtar	Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare i miratuar në vitin 2017	Ligji për të Drejtat e Pakicave Kombëtare i miratuar në vitin 2003	Ligji për të Drejtat dhe Liritë e Minoriteteve i miratuar në vitin 2006	Marrëveshja e Ohrit (2001) dhe Ligji për Promovimin dhe Mbrojtjen e Anëtarëve të Komuniteteve (më pak se 20%) i miratuar në vitin 2008	Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Pakicave Kombëtare i miratuar në vitin 2002	Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre i miratuar në vitin 2011

Konventa Kuadrj për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCNM)	Shtet Anëtar i Konventës që nga viti 1999	Shtet Anëtar i Konventës që nga viti 2000	Shtet Anëtar i Konventës që nga viti 2006	Shtet Anëtar i Konventës që nga viti 1997	Shtet Anëtar i Konventës që nga viti 2002	Monitorim Specifik në Përputhje me Marrëveshjen e vitit 2004 midis UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës.
Numri i Pakicave të Njohura Zyrtarisht	9 Pakica Kombëtare	17 Pakica Kombëtare	-	6 Pakica Kombëtare	19 Pakica Kombëtare	7 Komunitete
Kriteri i Shtetësisë për Përcaktimin e Pakicave Kombëtare	Po	Po	Po	Po	Po	Jo
Shifra të Azhurnuara të Popullsisë së Pakicave	Të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 nuk mund të konsiderohen të besueshme për shkak të bojkotit nga pakica greke dhe nga pakicat e tjera	Regjistrimi i vitit 2013 nuk dha informacion të besueshëm dhe të azhurnuar mbi përbërjen etnike të popullsisë	Shifrat e regjistrimit të vitit 2011 nuk dhanë një indikacion të saktë të numrit të personave që u përkasin pakicave kombëtare	Besueshmëria e rezultateve të regjistrimit të vitit 2011 është pare gjerësisht si e dyshimtë për një larmi arsyesh	Regjistrimi i vitit 2011 u bojkotua nga pakica shqiptare kurse përfaqësimi i romëve ishte i ulët	Të dhënat për përbërjen e popullsisë nuk janë plotësisht përfaqësuese sepse regjistrimi i vitit 2011 nuk u zhvillua në Veri të vendit dhe u bojkotua pjesërisht nga Serbet në Jug
Përdorimi i Gjuhëve të Pakicave Kombëtare	Një prag prej 20% që duhet të llogaritet në lidhje me popullsinë e secilës prej 61 bashkive. Përdorimi i gjuhëve të pakicave rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.	33% i popullsisë së bashkive të përbëhet nga persona që i përkasin pakicave kombëtare.	Në njësitë e qeverisjes lokale, në të cilat anëtarët e pakicave dhe komunitetev e të tjera përbëjnë shumicën ose të paktën 5% të popullsisë sipas rezultateve të dy regjistrimeve të fundit.	Gjuhët që fliten nga të paktën 20% e popullsisë së vendit konsiderohen gjuhë zyrtare. Çdo person që jeton në një njësi lokale në të cilën 20% e popullsisë flet një gjuhë zyrtare tjetër nga ajo Maqedonase, mund të përdori gjuhën zyrtare që preferon për të komunikuar me administratën publike.	Njësitë e qeverisjes vendore duhet të pranojnë në mënyrë të barabartë përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave kur përqindja e pakicave në krahësim me numrin e përgjithshëm të popullsisë arrin 15% në përputhje me rezultatet e regjistrimit të fundit.	Shqipja dhe serbishtja konsiderohen të dyja gjuhë zyrtare. Gjuhët turke, boshnjake dhe rome mund të kenë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal ose të përdoren zyrtarisht në të gjitha nivelet siç parashikohet nga Liqji për Përdorimin e Gjuhëve .
Edukimi në Gjuhën e Pakicave	Shkollat me mësimdhënie në gjuhën e pakicave lejohen në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku pakicat jetojnë tradicionalisht ose në një numër të konsiderueshëm. Hapja e klasave në gjuhën e pakicave kushtëzohet në një numër kriteresh, duke përfshirë pragun e jo më pak se 15	Fëmijët që i përkasin një pakice kombëtare duhet të përbëjnë 33% të popullsisë së shkollës që shkolla të jetë e detyruar të ofrojë mësimdhënie në gjuhën e pakicave.	Pakicat dhe anëtarët e tyre kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e tyre në arsimin e përgjithshëm dhe profesional, në varësi të numrit të nxënësve dhe mundësive financiare të	Në lidhje me arsimin fillor dhe të mesëm, udhëzimet duhet të ofrohen në gjuhën amtare të nxënësve. Arsimi në nivelin universitar sigurohet në gjuhët që fliten nga të paktën 20% të popullsisë së Meqedonisë të	Përgjegjësinë për arsimimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare në gjuhën e tyre e kanë Këshillat Kombëtar të Pakicave. Për të ushtruar këtë të drejtë, mund të përcaktohet një numër minimal i nxënësve i cili	Komunitetet kanë të drejtën e arsimit publik të të gjitha niveleve në një nga gjuhët zyrtare. Qeveria vendos pragje të arsyeshme për hapjen e klasave në gjuhët e komuniteteve.

	nxënësve për klasë.		Malit të Zi.	Veriut, në bazë të marrëveshjeve specifike.	mund të jetë më i vogël se numri i nxënësve i paraparë me ligj për formulimin e formave të duhura të shkollimit dhe arsimit.	
Institucionet ose Organet që Përfaqësojnë Pakicat	Komiteti për Pakicat Kombëtare	Këshillat e Pakicave Kombëtare në nivel qendror dhe lokal	Këshillat e Pakicave	Agjencia për Përbushjen e të Drejtave të Komuniteteve	Këshilli Federal për Pakicat Kombëtare dhe Këshillat e Pakicave Kombëtare	Këshilli Konsultativ i Komuniteteve
Ratifikimi i Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare	Shqipëria nuk ka nënshkruar akoma Kartën. Në vitin 2019, përfaqësues të Shqipërisë dhe Këshillit të Evropës u takuan për të identifikuar dispozitat që Shqipëria mund të nënshkruaj dhe ratifikojë.	Karta u ratifikua në 2010 dhe hyri në fuqi në 2011.	Karta u ratifikua dhe hyri në fuqi në 2006.	Maqedonia e Veriut e ka nënshkruar Kartën që nga viti 1996, por ende nuk e ka ratifikuar atë.	Karta u ratifikua dhe hyri në fuqi në 2006.	Kosova nuk është ende shtet anëtar i Këshillit të Evropës.

Konkluzionet

Përfundimi në kohë i prioriteteve në fushën e mbrojtjes së pakicave, të cilat janë ende në fazë fillestare, do të përcaktojnë shpejtësinë, gatishmërinë dhe qëndrueshmërinë e të gjithë procesit. Sektori i të drejtave të njeriut, përfshirë mbrojtjen e minoriteteve, është me rëndësi thelbësore për përparimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Shqipëria ka treguar sinjeritet dhe përkushtim në këtë sektor vendimtar, por kjo duhet të inkurajohet më tej përmes mbështetjes së BE-së për të mbrojtur procesin dhe për të adresuar vështirësitë që mund të shfaqen në të ardhmen. Shqipëria duhet të përmirësojë aftësitë e adresimit të këtyre çështjeve serioze përmes një sistemi demokratik ligjor dhe një qasjeje të bazuar në të drejtat themelore për mbrojtjen e pakicave në sistemin ligjor të vendit. Vendi po përballet me probleme të rënda strukturore dhe institucionale, dhe normalisht do të marrë kohë derisa të adresohen të gjitha çështjet në mënyrë të mjaftueshme. Pavarësisht problemeve të brendshme, Shqipëria do të përpiqet tju përmbahet angazhimeve të përcaktuara nga BE-ja, por pa një ndihmë të fortë të jashtme, nuk ka gjasa të ketë sukses. Topi nuk gjendet vetëm në fushën Shqiptare. BE-ja ka përgjegjësitë e veta për të çuar mbrojtjen e pakicave në një nivel tjetër përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme ndaj pakicave në nivel Evropian që do të rriste besueshmërinë e Brukselit në sytë e shteteve kandidatë ose potenciale kandidatë. Gjithashtu, BE-ja duhet të marrë përgjegjësitë e saj për të siguruar që shtetet aspiruese të veprojnë në mënyrë me efektive drejt përbushjes së detyrimeve në lidhje me mbrojtjen e pakicave kombëtare. Kjo lojë luhet në dy fusha të ndryshme, dhe vetëm një lojë e ndershme do të sjellë përfitime për të gjitha palët.